



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30336/23
Kaçanik, 21.11.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30 nëntor 2023 (e Enjte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e dhjetë (10) të Kuvendit të Komunës të datës 30.11.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 ZK Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore komuna Kaçanik;
3. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24386//23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 ZK Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore komuna Kaçanik;
4. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 ZK Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar komuna Kaçanik;
5. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;
6. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë;
7. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);
8. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
9. Kërkesa e MMPHI për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/01- 27224/23 për caktimin e Lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;
10. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-27481/23
Kaçanik, 31.10.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 tetor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje 27 anëtarë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Zahir Doda- DA, Sali Malsiu-DSHMS, Pranvera Loku-Zharku, Qamil Stagova-DUKMM, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 27 anëtarë, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 31 tetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, pronën komunale, kompanisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike -KEDS, për vendosjen e trafostacioneve (**Hequr**);
6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;
7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
8. Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;
9. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023;
10. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP;
11. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku;

12. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;
13. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;
14. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I;
15. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “KAÇINKA” L.L.C;
16. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”;
17. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023;
18. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 ZK Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore komuna Kaçanik **(Hequr)**;
19. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24386//23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 ZK Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore komuna Kaçanik **(Hequr)**;
20. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 ZK Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar komuna Kaçanik **(Hequr)**.

Pika 5 është hequr nga rendi i punës në mbledhjen e KPF me kërkesën e drejtorit të DUKMM, pasi nuk ka qenë e përgatitur sa duhet. Meqë ka shumë pikë, a keni propozim me bërë pauzë në mes të pikave. Pikat 18-20 kanë vlerësim negativ nga MAPL. Sipas kërkesës së MAPL i kam proceduar për rishqyrtim këto pikë. Çështje të kësaj natyre kemi pasur edhe me herët, të cilat janë vlerësuar pozitiv nga MAPL. Për këtë e kam shqetësimin tim në MAPL edhe me shkrim. E hapi diskutimin:

z. Rustem Zenuni: Varësisht prej ecursisë së seancës e vlerësojmë çështjen e pauzës.

z. Agim Mani: Në mbledhjen e KPF jemi kuptuar që pikën 5 me larguar nga rendi i punës. Për kundër kësaj, na ka ardhur material për mbledhje tre herë, pa u hequr pika 5, atëherë e shqyrtojmë edhe këtë pikë, se ky rend i punës ka shkuar edhe në MAPL. Ndërkaq pikët 17-20 kërkoj të hiqen nga rendi i punës, se kanë ardhur me vonesë. Të pikat 18-20, mirë që i ke shkruar MAPL, presim përgjigje për 30 ditë. Nëse përgjigja vjen negative, i rishqyrtojmë në mbledhjen vijuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimet kanë ardhur të premtën në ora 15:30. Pajtohem me propozimin e juaj Agim, atëherë a jeni të pajtimit me i tërhequr këto pikë?

z. Agim Mani: Ne jemi që edhe pika 17 të hiqet se ka ardhur me vonesë, ndërkaq pika 5 të mbetet në rend pune, për arsyet e cekura.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 5 është tërhequr nga propozuesi në KPF. Ne nuk mundem kundër vullnetit të drejtorit me shqyrtuar këtë pikë. Të pika e 17 materiali për KPF ka ardhur me vonesë, ndërkaq për KK ka qenë brenda afatit ligjor.

z. Adnan Reka: E sqaroj edhe Agim Mani që tre konfirmime na kanë ardhur pa u ndryshuar rendi i punës. Materiali ka shkuar edhe në MAPL, për atë ne po kërkojmë me shqyrtuar pikën

5. Të pika 17, ka pasur kohë të mjaftueshme me u proceduar kjo pikë, ndërkaq na ka ardhur 3 ditë pune para mbledhjes e jo 7 ditë pune.

z. Agim Çaka: Të renditja e pikëve 8 dhe 9, mendoj se renditja duhet të ishte e kundërta.

z. Rustem Zenuni: Pika 5 jemi me u hequr dhe me proceduar për mbledhjen vijuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimi është që pikat 5, 18, 19, 20 me u hequr nga rendi i punës.

z. Rustem Zenuni: Unë jam vetëm pika 5 me u hequr.

z. Naim Beça: Pika 5 është hequr, ndërkaq pikat 17, 18, 19, 20, me i lënë për mbledhjen vijuese.

znj. Ardita Rrahmani: Unë nuk po e shoh të arsyeshme pikat e fundit me u hequr nga rendi i punës.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 17 nuk ka arsye me u hequr nga rendi i punës.

z. Adnan Reka: Për këtë herë pajtohem për pikën 17, ndërkaq për hera tjera me qenë me të vëmendshëm në këto çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Rendin e punës pa pikën 5, 18, 19, 20 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 16 pikave si vijon:

- Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
- Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;
- Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
- Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
- Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
- Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;
- Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “MUJA” OP;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “KAÇINKA” L.L.C;
- Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”;
- Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023.

Kryesuesi i Kuvendit: Konstatoj me kaluar në shqyrtimin e pikave të aprovuara sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Nëse ka kush vërejtje, lë të paraqes.

z. Agim Mani: Të fjalimi im, fjala “lëndohem” duhet të jetë “ofendohem”. Ndërkaq nuk pajtohem me fjalimin e pozitës që ka theksuar për bojkotim të mbledhjes. Kryesuesi është dashur me iu dhënë vërejtje.

z. Rustem Zenuni: Unë e kam vlerësuar ashtu shkakun e bojkotimit të mbledhjes, për shkak të buxhetit dhe e kam potencuar.

z. Naim Beça: Ne i kemi marrë votat e qytetarëve, qytetarët e dinë që ne e lëshojmë mbledhjen, kur nuk pajtohem për diçka.

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbalin e mbledhjes se kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri, me një vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 27.09.2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-24557/23. Procesverbali do të publikohet me ndryshimin.

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Në Listat e pagave, neve anëtarëve të KK nuk na figuron përvoja e punës, përpos kryesuesit të KK. Për këtë çështje kam biseduar me dike qysh në fillim të mandatit, nuk e di me kënd, me kanë thënë se nuk është problem kjo çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Ata që janë në institucione publike dhe kanë përvojë pune edhe më herët, me vërtetim nuk ka kush që të mohoj atë të drejtë. Adresa është të Zyra e personelit.

Naim Beça: Shqetësimet e qytetarëve të cilat po i ngrisim, nuk po rezultojnë në të mirë të tyre. Nëse heshtjen e shihni si ndëshkim, atëherë nuk ka arsye me u ngritur çështje në KK.

Propozoj që pozicioni: Pyetjet dhe Kërkesa me hequr nga rendi i punës, se nuk po realizohen.

1.Rreth rrotullimi në rrugën “Ismail Raka” i filluar në vitin e kaluar, kam bërë pyetje pse ai rreth rrotullim aty. Po e përsërisë këtë pyetje, sepse qytetarët janë në terr informativ, ndërkaq përmes taksave të tyre bëhet ai rreth. Duke e njohur atë hapësirë, kam dyshimet e mia rreth atij rrethi.

2.Që sa herë kam kërkuar me u mbuluar gropat në Rruga e Re dhe dritat në rrugën ” Sali Bajra’, por nuk janë realizuar.

Ne jemi qytetarë të këtij vendi, nuk është në rregull për inati mos me rregulluar këto defekte, ndërkaq fajin ia adresoj, drejtorit të drejtorisë.

3.Çështja e parkingjeve, Pyetja ka qenë për rishqyrtimi të parkingjeve dhe rrugës një kahe. parkingjet po bëhen para dyerve, edhe pse shënohet se nuk është i lejuar parkimi para dyerve. Të rruga një kahe, banorët e rrugës Rakoc, për me kryer shërbime, nuk mundën me u kthyer rrugës nga kanë ardhur.

4.Të çështja e ndërtimeve të parkut, A është park apo shesh ? Sheshi është vendi i sheshtë, me qenë park duhet mbjellë drunjtë që është e lejuar e jo drunjtë që e shkatërrojnë çimenton. Të vendosja e kockave, kam vërejtje se hapësira në mes, është shumë e madhe.

5.Të gjimnazi “Skënderbeu, kanë filluar punimet, askush nuk lodhet se a lëndohet dikush aty, njëjtë është edhe të shkolla tjetër.

Është bërë një vend i gërditshëm, zënë në hekura në çimento kur të dalësh në qytet. Qytetari paguan taksat, ndërkaq nuk iu intereson a ka komuna kontratë apo jo, ai donë me shëtitur lirshëm. Krahësuar me komunat tjera, Shtimja të marrim shembull si e kanë bërë parkun, ndërkaq këtu të ne dy vite një park.

6. Nevojat e qytetarëve për projekte, Asnjë komision nuk është dalë me shikuar se çka i nevojitet këtij vendi, me i shikuar rrugët etj. Unë jam për projektin e asfaltimit të rrugës në Biçec, se e meriton ai vend, por nuk e meriton dikujt me i shkuar asfalti të ahuri, ndërsa unë nuk kam asfalt duke jetuar midis qytetit, kockat që janë vendosur janë prishur.

7. Mos përfundimi me kohë i projekteve: Asnjë projekt këtu në Kaçanik nuk përfundon me kohë që 24 vite. A është bërë shkak apo me shkas, nuk e di, diçka këtu nuk është në rregull. Pse nuk u rregullua parku-sheshi me kohë? Me u rregulluar dritat, me u rregulluar asfalti të rruga e re dhe rrugët tjera, me u rregulluar rruga për këmbësor.

8. Objektet e komunës nuk janë në rregull, duke filluar nga kjo sallë e cila nuk i plotëson kushtet,

10. Deri kur kanë me qëndruar zyrtarët e QPS të shtëpia e kulturës, se kjo është në kundërshtim me ligjin se ajo është shtëpi e rinisë, e jo për pensionistë. Klubet e sportit janë pa zyre. Zyrtarët e QPS duhet me i larguar nga aty dhe me ua bërë një vend diku tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Parashtroni pyetje e mos u lëshoni në komente.

z. Betim Shala: I kam tre kërkesa: 1. Rruga Suljeman Kuka, në Zonën I urbane, taksohet, ndërkaq nuk i plotëson kushte elementare për shkak të kundërmimit nga kanalizimet. Kur mundet me u rregulluar kjo rrugë? Realizimi i këtij projekti nuk është shumë i kushtueshëm, duhen 5-6 puseta, 150m kanalizim, 180 m gjatësia e rrugës, 4.5 metra e gjysmë gjerësia.

2. Pyetje dhe kërkesë të cilën e ka ngritur me herët Naim Beça, për Shkallët që lidhin rrugën "Ismail Raka" dhe rrugën "Skënderbeu" dhe "Jehona Raka".

3. A ka marrë ndonjë veprim komuna në çështjen e punimeve të hekurudhës, se tani bëhet edhe rehabilitimi i rrugës "Skënderbeu"? Si do të jetë ajo pjesa tjetër kah hekurudha, a do të jetë trotuar apo trotuar me parkingje, apo nuk është bërë asgjë në këtë drejtim?

z. Adnan Reka: Kolegji AAB që është vendosur që disa muaj në objektin e banesës P+8 në Kaçanik në bulevardin "Ismajl Raka", A ka të nënshkruar ndonjë kontratë me komunën e Kaçanikut apo me dike tjetër? Qysh është e mundur me shfrytëzuar objektin e komunës, kush ia ka dhënë çelësin e atij objekti?

Kryesuesi i Kuvendit: Ka mundësi që Kryeministri i Kosovës, kërkesa me ka ardhur edhe mua, nuk është e identifikuar, nuk e mora përsipër me iu përgjigjur.

z. Adnan Reka: Pyetja ishte legjitime, çdo kush që ka frikë me shpreh shqetësimin dhe mendimin apo pyetjen, unë e kam obligim me shprehur si përfaqësues i qytetarëve të komunës, obligimi i juaj është me u përgjigjur.

Kryesuesi i Kuvendit: Ekzekutivi i komunës përgjigjet se unë nuk jam në ngjarje.

z. Adnan Reka: Përgjigjen e jep Ekzekutivi, ndërkaq kërkesa më është adresuar mua, kryetarit dhe kryesuesit.

z. Bashkim Luma: Si profesionist shëndetësor, shprehi një shqetësim në f. Gllaboçicë, që Zyra e vendit është dislokuar nga objekti i Bashkësisë fetare në hapësirat e AMF. Desha të ditë kush e ka dhënë këtë leje, që Zyra e vendit të jetë funksionale në një AMF.

z. Agim Çaka: 1. Po ndërlidhem me pyetjet e mbledhjes se kaluar, që ka të bëjë me rrugën, një kahe dhe parkingun në rrugën "Qamil Ilazi". Pasi qytetarët nuk i shohin përgjigjet, përgjigje e drejtorisë është si vijon: Në lidhje me pyetjen, thuhet se, ne kemi pranuar edhe një ankesë në Zyrën e Kryetarit dhe DSHPE, janë shprehur shqetësimet e pronarëve të bizneseve për rrugën një kahe "Qamil Ilazi", jemi përgjigjur në afatin e përcaktuar. Si po shihet ankesa ka pasur edhe nga banorët edhe bizneset. Ankesa kemi pasur shumica e anëtarëve të opozitës. Ky vendim shihet se është i paarsyeshëm dhe duhet me u anuluar, në fund thuhet ekzekutivi mund të merr vendim për ndryshimin plotësimin apo anulimin e këtij vendimi. Kjo po varët prej ekzekutivit me çka kujtoj se nuk është e vërtetë se qytetarët me bërë ankesë në gjykatë, vendimi mundet me u anuluar nga gjykata.

2. Sipas njohurive që kam, në lagjen Koxhaj është bërë një shpim për furnizim me ujë, i cili kishte me përmirësuar furnizimin e banorëve të asaj lagje. Pyetja: Sa ka kushtuar ky projekt? A e arsyeton projekti qëllimin për çka është bërë? Kam informacione se ajo pompë nuk është duke funksionuar. Mbeteni me kthyer një përgjigje në mbledhjen vijuese të KK.

3. Siguria e lëvizjes së banorëve të lagjeve Çaka dhe Zeneli, që disa lëvizin nëpër magjistrale. Kërkesa është: A ka mundësi me u bërë një trotuar aty, megjithëse kushtet teknike janë të vështira për realizim të trotuarit. A ka mundësi se paku ndriçim publik me pasur në atë pjesë, pasi shtyllat elektrike ekzistojnë aty, për me u pa nga veturat, qytetarët që lëvizin në atë pjesë, për mos me ardhur të ndonjë fatkeqësi me fatalitet.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë për sqarime. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Buxheti i komunës është më i madhi deri sot, edhe pse kërkesat e qytetarëve tejkalojnë buxhetin, por komuna kërkesat duhet t'i ketë në plan të harmonizuara me buxhetin. Ekzekutivi ka paraqitur raportin 9 mujor, për na informuar përmbushjen e planit, grumbullimin e mjeteve dhe realizimin e tyre në bazë të planit. Buxheti në vitin 2023 është 11,183.045€, prej tyre 862,378€ janë të HVK, 494,729€ € janë të hyrat e bartura nga viti paraprak, ndërkaq pjesa tjetër janë nga Granti qeveritar, të hyrat indirekte dhe donacionet. Të HVK për këtë periudhë: 733,899€, 85.08% e planifikimit vjetor. Kjo është për t'u përshëndetur, mirëpo këto mjete duhet t'i kthehen qytetarit në investime kapitale dhe të tjera, por kjo nuk ka ndodhë. Të HVK, janë shpenzuar 105,421€, 14.36%. Nga mjetet e bartura 494,729€, janë shpenzuar, 96,339€, vetëm 20%, edhe pse mjetet e bartura është dashur të shpenzohen në vitin paraprak. Edhe pse është alarmuar shumë për tërheqjen e këtyre mjete nga ministria, nuk i realizoni, duke pasur parasysh kërkesat e qytetarëve, gjendjen e komunës tonë që llogaritet një ndër komunat me të varfër në komunat e Kosovës, që ju udhëhiqni me këtë mendësi të qeverisjes.

Të taksat, me tepër janë inkasuar në 3 mujorin e dytë sesa në të tretin. Të parkingut, të planifikuar 7,000€, inkasuar 5,599€, d.m.th. pjesën ku e ka inkasuar komuna ka mbledhë një shumë të mjeteve, ndërkaq parkingjet tjera që i ka dhënë komuna në shfrytëzim, ka dalë minus, se paska mundësi nga parkingjet me përfutur komuna, por këtë herë keni dalë me minus. Kjo donë një studim. Shqetësim tjetër, Subvencionet dhe transferet, nga 415,454€ janë subvencionuar 188,186€, 45%. Vetëm DKRS ka kaluar mbi planifikim subvencionet, drejtoritë tjera kanë subvencionuar me pak, sidomos DZHET. Nuk e di si mundeni me u zhvilluar ekonomisht, kur subvencionet i keni zero. Shqetësim tjetër të investimet Kapitale-IK: planifikimi 3,428,203€, realizimi 1,444,038€ apo 42.12%, krahasimi 1,984,165 apo afër 2 milion euro të pashpenzuara, të cilat mjete është e pamundur të realizohen për 2 muaj. Ndoshta munden me u realizuar, për mos me dal mjetet në suficit buxhetor, por projektet nuk mbikëqyrën, bëhen pa kritere, dhe pa mbikëqyrje profesionale. Ketë po e themi se, ky raport i ka nxjerrë në pah edhe parregullsitë që kanë ndodhur. Shembull: Të rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale, të planifikuara, 220,000€, janë realizuar 199,999€, ndërkaq në ato urbane 159,000, të realizuara 25,227€ e barabartë me 225,226€. Është shqetësuese mirëmbajtja e rrugëve sepse 236,921€, kanë kushtuar me tepër sesa është investuar në asfaltimin e rrugëve. Kjo të bënë me kuptuar për nivelin e projekteve, është aq i dobët saqë kostoja e mirëmbajtjes së projekteve është me e madhe sesa realizimi i projekteve. 236,921€ me mirë është dashur me realizuar projekte sesa të mbulohen gropat. Atë që e tha Naimi me herët, janë shpenzuar shuma të mjeteve dhe nuk ka mirëmbajtje, kjo është një keq menaxhim. Në këtë raport financiar ka një diskrepancë të madhe të planifikimit dhe realizimit të kontratës së këtij projekti. Kërkoj sqarim nga drejtori që kontrata e këtij projekti të rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale, të planifikuara, është nënshkruar 199,999€, 9,000€ janë dhënë me tepër nga vlera e kontratës. A është përfunduar si projekt rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale? Të shpenzimet e shërbimeve kontraktuese, cilat janë shërbimet që i keni kontraktuar me shumën 126,000€.

znj. Ardita Rrahmani: Duke parë dhe analizuar raportin financiar për 9 mujorin, në LDK shprehim shqetësimin për mos planifikimin e duhur për sa e sa vite në qeverisje lokale. Gjithashtu shprehim shqetësimet për realizim të dobët për 42% të Investimeve kapitale, kur

dihet se kjo kategori ekonomike është ajo prej të cilës përfitojnë direkt qytetarët dhe dukshëm. E vetmja kategori me realizim të kënaqshëm është ajo e Pagave dhe mëditjeve, se është obligim realizimi i tyre, e jo çështje e menaxhimit.

z. Agim Çaka: Nëse i analizojmë kategoritë buxhetore, Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Investime kapitale, Shpenzimet komunale, Subvencione dhe transfere, është e mjaftueshme me kuptuar se këto kategori është dashur me kaluar mbi 60% realizimin, por nuk e kanë kaluar, pos Pagave dhe mëditjet e tha edhe Ardita që janë obligim realizimi i tyre. Kanë mbetur edhe 3 muaj, mund të kemi dështimi të planifikimit të programi i investimeve kapitale, sepse gjasat janë të vogla për realizimin e projekteve, dhe ky mosrealizim reflekton direkt në mungesën e përmirësimit të jetës dhe standardit të qytetarëve.

znj. Fitore Vishi: Raporti financiar për periudhën, Janar-Shtator 2023, i cili na ofron të dhëna të bollshme mbi ecurinë dhe treguesit relevantë rreth përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas programeve dhe dinamikën e buxhetit të shpenzuar, kategoritë dhe natyrën e shpërndarjes së mjeteve, rrjedhjen e parasë, si dhe treguesit tjerë që kanë pasur impakt në të arriturat e përgjithshme gjatë kësaj periudhe. Në këtë rast, unë do të ndalem në raportin e inkasimit të te HVK, të përshkruara në tabelën nr. 2, ku vërehet tejkalim i mjeteve të grumbulluara në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në këtë raport vërehet një sidomos një progres i dukshëm, në tatimin në pronë dhe lejet ndërtimore. Të 13 programet prezantohet saktësisht në tabelën e këtij raporti financiar, që për grupin parlamentar të PDK është i pranueshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën ia kaloj drejtorit, për sqarime të nevojshme.

z. Bahri Selimi: Të HVK realizimi 85% është i mirë, shpenzimi i buxhetit është pak i ulët, ndërkaq nuk i ka as 2 javë që MFET na ka lejuar bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2023, pasi që ministri i financave i pati bllokuar me një vendim dhe ai vendim ishte antiligjor. Tani mjetet i kemi në buxhet pas periudhës 30 shtator, ndërkaq mjetet e vitit 2022 i kemi bartur. Arsye tjetër e shpenzimit të ulët të HVK është se grantit qeveritar i japim prioritet në realizim, për shkak se i kemi të alokuar në fillim të vitit. Të HVK si e keni vërejtur edhe në raportet tjera, nuk i kemi në arkë, këto realizohen muaj për muaj, është problem planifikimi i shpenzimeve, se nuk e dimë saktë sa mblidhen. Ndërsa GQ mund të planifikojmë se e kemi në buxhet nga muaji mars dhe i planifikojmë shpenzimet. Gabime në TM2 dhe TM3 të HVK, se jemi duke i bërë do harmonizime me adekuate në TM3, ka pasur taksa tjera të DUKMM me tepër, por me kalimin e kohës përmirësohet regjistrimi i procesit të HVK, se zvogëlohen në një pozicion, por rriten në pozicionin tjetër në kodin përkatës. Subvencionet 45%, janë shpenzuar me shumë të kultura, të arsimit ende nuk është kryer realizimi i bursave, këto mjete realizohen sa herë deri në fund vit. 300,000€ janë këtë vit, ndërkaq shpenzohen se kanë nevojë klubet sportive, shoqëritë aktivitetet rinore që i kemi të parapara me buxhet. Nuk është shqetësim shpenzimi të kategoritë tjera shpenzuese buxhetore, të Investimet kapitale, mjetet e pashpenzuara një pjesë apo 50% e tyre janë të HVK të cilat mundemi me i bartur sipas shkallës së përcaktuar. Realizimi 100% është problem me arritur të IK edhe pse sa herë synojmë, e arrijnë ato komuna që kanë obligime ligjore në bazë të vendimeve të gjykatave në procedura përmbarimore. I keni pa raportet e institutit GAP, ato komuna që kanë realizuar IK 100% janë për shkak të vendimeve përmbarimore të gjykatave. Realizimi i IK është i kënaqshëm, nëse arrihet 75%. Besoj se e arrijmë, se bukur shumë ka arritur realizimi pas muajit shtator. Të kodet e rrugëve urbane dhe rurale, janë shpenzuar 225,000€, bëhet fjalë për rrugët që janë shtruar sivjet, ndërkaq mirëmbajtja përfshinë periudhën pas lufte deri sot -mirëmbajtjen e rrugëve të ndërtuara. Aty drejtori mundet me sjellë një raport të veçantë, aty nuk ka vetëm mirëmbajtje të rrugëve, por edhe pastrim të rrugëve, kontratë për ndriçim publik, sinjalizime vertikale horizontale etj. Shpenzimet e IK janë vetëm për sivjet. Kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve zakonisht janë 2 vjeçare, këtë e shikojmë edhe të prokurimi, një pjesë të shpenzimeve e ka marrë kontrata e vitit të kaluar, se ne nuk guxojmë me realizuar asnjëherë shpenzim mbi kontratë. Mundem me ua përcjellë me në detaje unë apo zyra e prokurimit shpenzimet për mirëmbajtje. Shpenzimet kontraktuese tjera, e potencova edhe atë ditë, se MFET i grumbullojmë me shumë kontrata të

ky kod, nga viti vijues kanë me qenë me specifike. Të Shuma 126,954€, janë për sigurim fizik të objekteve për komunë, shkolla, shëndetësi, kulturë, transporti i nxënësve është nga MSH, mbi 45,000€, ekspertiza juridike 3,000€ nga 600€ për 5 muaj. Hartimi i projekteve, janë paguar 6,822,62€, kontratë për qentë endacak, 7689 € janë shpenzuar deri tani, tjera janë 2500,05€, Të Ardita, u përmend mos planifikim i duhur, realizim i ulët i IK, mos t'i përsërisim se i përmendëm, të Agimi, Pagat dhe mëditjet nuk i kemi në dorë tonë.

z. Agim Mani: Nëse mendoni këtë kontratë me vazhduar në vitin vijues, nuk po thotë se ka përfunduar kontrata 19,0000€. Këtu është ajo çështja, se operatori ekonomik nuk e ka përfunduar punën para kontratës.

z. Bahri Selimi: Kontrata për mirëmbajtje të rrugëve nuk ka përfunduar ende.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundeni me marrë përgjigje të E-prokurimi, të drejtori përgjegjës për menaxhimin e këtyre kontratave z. Qamil Stagova.

z. Qamil Stagova: Në fund të vitit 2022, projekti nuk ka përfunduar. Tani nga i njëjti fond janë marrë mjete të vitit 2023. Për rrugë rurale janë shpenzuar mjete edhe për projekte të vitit të kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk i keni sot shifrat, i sqaroni më vonë. Kjo është si informatë, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023/ 01Nr. 400/01-27370/23.

3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Çka është në pyetje që kjo pikë u tërhoq nga rendi i punës në mbledhjen e kaluar ? A nuk po iu duket një tallje kjo për KK, vetëm se i keni numrat ? Në muajin e kaluar kërkuat me u tërheqë kjo pikë nga rendi i punës për rialokimin e këtyre mjeteve, me arsyetim se ministria na ka dërguar njoftimin se nuk ka mbetje arkeologjike. Tani po del se paska mbetje arkeologjike, sepse Instituti Arkeologjik i Kosovës bashkë me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, kanë refuzuar kërkesën për ndërtimin e parkingut nëntokësor, me arsyetimin se ka struktura arkeologjike. Kjo për mua është tallje në termat me të butë, sepse t'i kërkohet KK të hiqet kjo pikë nga rendi i punës, pa një informacion zyrtar, pastaj t'i kërkohet me hyrë në rend dite, se na erdhi njoftimi zyrtar, kjo është për mua tallje e KK. Kolegë të nderuar, a po e shihni autoritetin e juaj dhe autoritetin tonë, kur donë ekzekutivi na thotë me votuar, Për, kur donë na thotë me votuar, Kundër. Mua në të vërtetë me vjen keq për mënyrën sesi silleni me ne.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë drejtoresha nuk është prezentë në mbledhje për arsye të caktuara, po e themi atë që me ka thënë drejtoresha. Tallja ka ndodhur nga niveli qendror, se për një ditë na vinë dy vendime të ndryshme nga njëjti institucion, ku njëri thotë lejohet me punuar se nuk ka gjetje, ndërkaq vendimi tjetër vjen me vonë ku kërkohet me u anuluar vendimi se ka gjetje arkeologjike. Të dy vendimet mi ka treguar drejtoresha, dhe tallja vjen nga atje, jo nga këtu. Drejtoresha ka kërkuar në vazhdimësi përgjigje, janë emaillet zyrtare të saj, dhe në momentin që ka ardhur njoftimi se mundeni me punuar, është tërhequr pika, se jemi në rregull, pa e menduar se pas mbledhjes se KK na vjen vendimi tjetër që nuk na lejohet me punuar.

z. Bahri Selimi: E kemi sjellë vendimin në KK me 27.09.2023 me i rialokuar mjetet, sepse me 26 shtator ministria e Kulturës që e udhëheq Hajrulla Çeku, nga drejtoria e kësaj ministrie, se mundemi me punuar se nuk ka kurrfarë mbetjesh arkeologjike. Nga ju kemi kërkuar mirëkuptim dhe e kemi tërhequr atë pikë. Tani kemi kërkuar me u rialokuar mjetet, vendimin e keni të bashkëngjitur me propozim vendim, ku thuhet refuzohet Kërkesa për ndërtimin e parkingut nëntokësor pranë objektit të komunës në PK, investitor komuna Kaçanik. Pyetja

është: Çka kishe bërë ti Adnan në këtë rast, po të ishte në vendin tonë ? Mjetet janë GQ, janë nja 100,000€, 10,000€ i kemi shpenzuar, ndërkaq shumë tjetër e rialokojmë të e njëjta drejtori në një projekt tjetër, që nuk ka pasur mjete me herët me u planifikuar ky projekt. A i kishe lënë ti mjetet me u kthyer në qeveri?

z. Adnan Reka: E para, unë i referohem vendimit, e jo informatës. Nëse keni pasur vendim të ministrisë, është dashur edhe vendimin paraprak me ia bashkëngjitur. Ne nuk kemi vendim që thuhet se nuk ka mbetje arkeologjike. Nëse ishin bashkëngjitur dy vendime, atëherë e kishim vërtetuar se faji nuk është i juaji, ndërkaq në këtë rast me vetëm një vendim, fajin ua adresojmë juve. Prandaj, unë nga fillimi po kërkoj seriozitet në KK, çdo dokument me na ardhur me kohë, se nëse jeni serioz dhe dokumentet i marrim me kohë, gabimet i keni me të vogla.

Kryesuesi i Kuvendit: Ka qenë e mirë kuptueshme edhe atë ditë kur është tërheqë pika, e ka sqaruar edhe drejtoresha.

z. Adnan Reka: A duhet t'punojmë me mendime apo me dokumente zyrtare? Bashkë me këtë vendim, ne është dashur me pasur edhe vendimin paraprak, se ne nuk kemi pasur vendim, me vjen keq por ky është gabim i juaj. Institucioni nuk funksionon vetëm me mirëbesim, por me letra e dokumente. Vendimi është tjetër, raporti është tjetër.

z. Bahri Selimi: Ne vendimin e kemi pasur me 26 shtator, mbledhja ka qenë me 27 shtator. Ne nuk kemi pasur mundësi, se vendimi ka ardhur një ditë para seancës. Unë e kam marrë vendimin me veti dhe e kam shpjeguar. Ka qenë raport i departamentit në kuadër të MKRS që merret me trashëgimi kulturore.

z. Rustem Zenuni: E para: Kërkoj nga drejtori që raportin e MKRS me na dërguar në email. E dyta: Për mua nuk janë shumë me rëndësi këto vendime kontraverse, se jemi duke u ballafaquar me këto të nivelit qendror, qoftë për ndërrim destinimi apo çështje tjera. Kur çështjet e një mbledhje, vendimet për këmbim të pronave kalojnë në ministri, ndërkaq të një mbledhje tjetër jo, kjo nuk është në rregull. Pastaj e kemi çështjen e dy vendime për parking të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Me vjen keq në dorë të kujt kemi mbetur dhe kush vendosë për fatin tonë.

z. Selajdin Troni: Unë i kam pa edhe emaillet që ia kanë dërguar drejtoreshës, ku kanë theksuar se nuk ka mbetje arkeologjike dhe kemi vendosë për parkingun. Shpresoj të mos jetë kjo çështje politike, nuk është në rregull që i njëjti institucion me i sjellë 2 vendime kontraverse dhe me u penguar puna këtu, se ajo pjesë ka mbetur si gjërmadhë. Naimi që tha jeni për ndarje provinciale, nuk është në rregull, se nuk jemi për ndarje provinciale, kjo nuk është mirë me u përdorë.

z. Adnan Reka: Nuk është çështje politike çështja e parkingut. E para, unë kam dëshirë me pasur struktura arkeologjike si kanë thënë, se tregon për lashtësinë e këtij vendi, për identitetin tonë. E dyta, komuna është dashur me ditur, a me filluar me punuar aty, e jo me filluar punën, pastaj me ardhur në këtë gjendje. Paraprakisht duhet konsultuar ekspertët, me bërë një farë plani, se kjo çështje nuk shkon kështu. Institucioni nuk bënë me marrë veprime, pa qenë i qartë dhe me u siguruar se këtu nuk po thotë se kanë qenë 2 vendime, por një raport dhe një vendim, vendimi dhe raporti kanë dallime të mëdha.

Kryesuesi i Kuvendit: Po të ishte drejtoresha këtu, e kishte sqaruar, por na rëndove bukur rëndë se theksove se na e keni ulur dinjitetin, po bëni hajgare me ne. Jo Adnan, dikush tjetër po bënë hajgare, jo ne. Nuk ia kemi ulur dinjitetin askujt, por jemi ndeshë me 2 dokumente. I pari në mbledhjen e kaluar, tjetri ka ardhur me ndërprerë punën.

znj. Ardita Rrahmani: Si keni menduar që këto mjete me i destinuar për ngrohje, sepse ngrohje ka administrata komunale? A ka projekt detal, nëse po, cila kompani e ka realizuar?

z. Agim Mani: Pajtohem me vendimin e ministrisë se ai është organ profesional, ndërkaq çështja është se jeni duke bërë rialokim të shumës 50% të mjeteve në një kod buxhetor, kjo nuk është e lejuar. Shumën 89,000€ jeni duke i bartur për sistemin e ngrohjes, ndërkaq projekti është 189,000€. Projekti i ka kaluar procedurat e tenderimit me 21.09.2023, tenderi është mbyllë me 13.10.2023. Nëse nuk i keni pasur mjetet, si e keni tenderuar? Kanë qenë 3 operatorë, operatori me i lirë 176,362€. Ne duhet të fokusohemi të bartja e mjeteve 50%, se nuk keni të drejtë me i bartur. Nëse nuk i keni zotuar mjetet, nuk keni pasur të drejtë me hapë tenderin, se kjo nuk është e ligjshme. Për ne është shqetësuese, e jo vendimi i qeverisë, ndërkaq numrat i keni, mundeni me miratuar.

z. Adnan Reka: Sa % të mjeteve keni të drejtë me i bartë sipas ligjit, nga një projekt?

z. Bahri Selimi: Brenda kategorisë buxhetore, mund të bartën 100% e mjeteve, ndërkaq të transferet 50%, 25% dhe 5%.

z. Agim Çaka: Ne jemi duke rialokuar mjete nga një projekt në një projekt tjetër, për arsye të një vendimi të qeverisë. Ndërkaq, a ka vepruar mirë qeveria apo jo, është çështje tjetër. Rialokimin është i lejuar dhe duhet bërë, por çështja është, pse kemi ardhur deri këtu? Për mos me na ndodhë këto, duhet të bëhen planifikimet me kohë, nuk duhet me filluar punimet pa qenë në rregull çështjet paraprake. Me pas bërë debat me qytetarë, ishte ditur për mbetjet arkeologjike, për faktin se këtu afër është xhamia. Me shqetësuese është tani që oborri i komunës ka mbetur në gjendje-gërmadhë. Sa ka me qëndruar kështu dhe kur ka me u sanuar gjendja dhe a do të kemi të drejtë me kthyer në gjendjen e mëparshme? Nëse nuk kemi të drejtë, është problematike për gjendjen e krijuar, kjo është temë tjetër dhe duhet debatuar ndonjëherë tjetër.

z. Agim Mani: Projekti kushton 189,000€, janë të zotuar mjetet. Ku po i dërgojmë këto mjete, se janë kryer procedurat e prokurimit, tenderi është fituar?

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse një pjesë e mjeteve kanë qenë nga të HVK, ato i tërheqim, mbesin vetëm ato të Grantit qeveritar, dhe mos me humbur këto mjete i riallokojmë në projekt tjetër. Drejtori i financave i dinë më mirë me i shpjeguar.

z. Bahri Selimi: Të parkingu na i kanë ndalë punimet, u akuzuam nga Adnani. Qëllimi i këtij propozim vendimi është, me bërë ndryshime kur nuk shpenzohen mjetet, mos me mbetur mjetet që janë grant qeveritar. Buxhetin me të madh e marrin pagat, ndërsa 30% Investimet kapitale-IK. Këto mjete për IK, po mundohem me i shpenzuar në interes të qytetarëve. Kemi kërkesë nga DAP për me bërë sistemin e ri të ngrohjes. Ky projekt ka qenë i koduar, se për projekte tjera kishim mundur me miratim të juaj dhe të qeverisë 15% me u bartë, shuma tjetër kishte ngelë suficit buxhetor. Të e njëjta drejtori kemi të drejtë me shpërndarë shumën 100%, se ky projekt është me buxhet për vitin 2023. Edhe pse kontrata është 190.000€, e përfshinë edhe vitin e ardhëm. Me buxhet, 330,000€ janë për parking nëntokësorë.

z. Agim Mani: Të projekti i rregullimit të ngrohjes, i kemi mjetet, procedurat e tenderimit janë kryer, ndërkaq ju po procedoni ende mjete. Projekti kushton 176,362€, me çka edhe mbesin mjete, se nuk mundesh me zhvilluar procedura tenderuese pa i zotuar mjetet.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Për sivjet jemi duke i rialokuar 89,000€. Kontrata për parkingun është 444,000€. Sivjet nuk i kemi 330,000€, kontrata është nënshkruar sivjet, në shtator u aprovua buxheti edhe për 330,000€. Shumën 89,000 € i transferojmë sivjet, pjesën tjetër në vitin tjetër.

z. Bahri Selimi: 100, 000€ i ka pasur projekti i parkingut nëntokësor, i bartëm vetëm 89,000€ se 10,000€ janë shpenzuar me herët. Nëse e keni pa, të rregullimi i ngrohjes qendrore, janë 0€ mjete.

z. Adnan Reka: Ne po debatojmë prej fillimit për një keq planifikim menaxheriale dhe financiare. Lokacionit të parkingut është dashur me i bërë fizibilitet, se ka pasur mure aty edhe mbi tokë, dhe e kanë ditur që muret janë mbi 100 vjet. Unë e kam përmendur, ndërkaq nuk jam ekspertë, çështja është se ju keni dashur brenda natës me rrënuar.

z. Sabedin Vishi: Ky projekt nga kur ka filluar, është tentuar me manipuluar se nuk po i ndërpresim punimet, gjë që e kemi të argumentuar se në momentin që na ka thirrur arkeologu, menjëherë kemi intervenuar me i ndërprerë punimet. Për hir të qytetarëve po e elaboroj nga fillimi. Në momentin që na kanë thënë me i ndërprerë punimet, e kemi ndërprerë punën. MKRS e ka formuar një komision vlerësues të arkeologëve, me shikuar se a ka vlera arkeologjike. Ata kanë ardhur janë konsultuar me ne, kanë kërkuar me i ndërpresë punimet, punimet kanë qenë të ndërprera, dhe kanë kërkuar me bërë njëfarë studimi se a ka diçka aty apo jo. Ata kanë kërkuar kohë, se ministria nuk kishte pas qysh me i ecur procedurat, se nuk kishte pas as ekipe të posaçme për këtë punë e as mjete të punës. Ne, pa e pasur obligim, i kemi ofruar ndihmë me punëtorë, mjete të punës, e që janë shumë falënderues edhe MKRS dhe komisioni vlerësues i arkeologëve. Me 26.09.2023 komisioni e bënë konfirmimin se aspekti arkeologjik është i përfunduar, lokacioni nuk paraqet vlera arkeologjike. Me 27.09.2023 na ka ardhur me email konfirmimi tjetër nga i njëjti komision se nuk guxon me punuar, se ka vlera arkeologjike aty. Drejtoresha e DAP tërë kohën ka kërkuar me na dhënë një verdikt përfundimtar, me punuar ose jo, para se të miratohet buxheti, që t'i orientojmë këto mjete. Tani e merrni me mend se nga kush jemi tallë. Me 12.10.2023 na ka ardhur vendimi përfundimtar se nuk guxojmë me punuar. Nëse dikush e ka ditur me herët që u tha, pse nuk jemi njoftuar, se parkingu nëntokësor ka qenë i paraparë me buxhet kur e kemi votuar buxhetin e këtij viti. Kërkesa me i ridestinuat këto mjete, nuk është në fajin e komunës, por në fajin e ministrisë. Argument janë shkresat. Kërkoj kryesues me qenë me konstruktiv edhe si KK edhe si ekzekutiv, se pjesa dërmuese e debatit nuk po shkon mirë, se jemi duke u ndjekur nga qytetarët, e mos t'i shfrytëzojmë kamerat, se nuk është gjithçka vetëm zi, se është punuar. Këtë e kanë vlerësuar qytetarët, se u tha në fillim që nuk është punuar asgjë.

z. Rustem Zenuni: Nuk e di pse është duke iu penguar me i destinuar mjetet për rregullimin e një problemi që e ka pas komuna? Këta (subjekti opozitë) sikur po duan që këto mjete të kthehen në qeveri dhe po luftojnë që projektet tona këtu me dështuar, investimet me dështuar, nuk di ku po jetojnë këta, në Kaçanik, Shtime apo në Podujevë. Nëse duam me u zhvilluar ky vend, nëse këto mjete janë në interes të qytetarëve, mundësitë janë këto. Unë nuk e dëgjova asnjëherë opozitën duke u ankuar, pse nuk kemi asnjë investim nga niveli qendror? Pse nuk po ankoheni fjala vjen që shkolla në f. Doganaj ka mbetur në gjysmë?

z. Bahri Selimi: Përmende Rustem edhe mungesën e investimeve nga niveli qendror në shkollën "Emin Duraku"?

z. Adnan Reka: Ne iu kemi thënë kryetar, nënkryetar kur u votua buxheti, por nuk na keni dëgjuar. Nga viti 2017 kemi thënë së aty ka mbetje arkeologjike. E kam të potencuar në facebookun tim, por çdo kërkesë, çdo pyetje e jonë, hasë në veshë të shurdhër. E dyta, ju tërë kohën po na tregoni se keni pas një raport prej ministrie, atë raport nuk na i keni ofruar, raport me vendimin nuk janë të barabartë. Për me qenë ne të bindur se faji është diku tjetër, është dashur me na ofruar qysh herët ato shkresa, edhe pse raporti me vendimin dallojnë.

Kryesuesi i Kuvendit: E shterëm këtë temë, raporti ka dal nga një organ profesional që thuhet se nuk ka mbetje arkeologjike, ndërkaq vendimi ka dal nga një organ politik. Vendimi është në kundërshtim me raportin, por nuk po dua me hyrë në atë pjesë.

z. Adnan Reka: Vendimin e ka lëshuar Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Arkeologjike, ndërkaq dokumentin tjetër nuk e di.

z. Bashkim Luma: Nga drejtori i Buxhetit dhe Financave, Nënkryetarit të komunës dhe Shefi grupit të PDK, ne po na konsideroni zëdhënës të qeverisë. Ne nuk jemi përgjegjës këtu se a po punon qeveria apo jo, është Kryetari i Komunës që takohet atje me sekretarët dhe me ministrat dhe atij i bëni pyetje, jo neve.

z. Agim Çaka: Me është përmendur emri që dy herë, se e di që për të njëjtën temë nuk kemi të drejtë me marrë fjalën 2, 3 herë. Rialokimin e mjeteve duhet të bëjmë. Në raportin paraprak, e pamë se janë shpenzuar mbi 10,000€, qytetarëve duhet me ua bërë me dije që ky projekt që është nisur pa plan, është bërë punë, janë shpenzuar 10,337€. Këto mjete janë shpenzuar, projektet e mira duhet ecur përpara, ndërkaq projektet e këqija duhet ndalur.

Kryetari i Komunës: Nëse ka thënë Adnani se nuk e di a ka thënë, por nëse ka thënë e nuk e kemi marrë parasysh, është për keqardhje. Ka qenë baraka, është hequr dhe askush nuk ka paraqitur ndonjë problem as nga këtu as nga ministria, se as unë, se me pas ditur nuk e kisha projektuar me i paraparë 400,000€ aty, dhe me proceduar këtë çështje para juve. Ne me drejtoreshën kemi qenë në takim, i kemi pyetur çka pas kësaj, se lokacioni mund të shkoj deri të objekti policor. Ata na kanë thënë vetëm muri ka me u konservuar, dhe pjesa tjetër mbetet ashtu. Nuk me është dukur në rregull, vendimi është nga ekspert të nivelit qendror dhe kam me respektuar, kjo ka me mbetur gjërmadhë.

z. Naim Beça: Kjo ndërtesë-komuna është e ndërtuar mbi gjërmadha, sa e di nga babai im. Desha me i thënë Nënkryetarit se nuk shoh vetëm zi, ne jemi opozitë dhe i shohim dobësitë e juaja.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me, 16 Për, Kundër 7, Abstenim 3. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023/ Lënda 01Nr. 104/03-27125/23.

Pas kësaj pike, Kuvendi i Komunës bëri një pauzë prej 30 minutash. Pas pushimit të pauzës, Kuvendi vazhdoi me punimet me pikët e mbetura.

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu për sqarime të nevojshme. E hapi diskutimin, ndërkaq kërkoj t'i përmbahemi rregullores:

z. Agim Mani: Mendoj se të kjo pikë, është keq planifikim i radhës nga ana e ekzekutivit. Të Subvencionet dhe transferet, janë planifikuar një shumë e mjeteve, nuk është arritur me u realizuar edhe pse kanë qenë shumë të nevojshme këto mjete për qytetarët. Kur të miratohet buxheti, ju mund të krenoheni me ndarjet në programet buxhetore, por këto shuma nuk po realizohen deri në fund të vitit.

z. Adnan Reka: Të pika 2. thuhet: Këtij propozim vendimi i janë bashkangjitur formularët nga MFET të plotësuar me shumat e lëvizura sipas nën programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve. Ne, nuk i kemi formularët, dhe nuk e di si mund të diskutojmë për të dhënat që nuk i kemi.

z. Bahri Selimi: E pranoj, se kemi harruar me bashkangjitur formularët, por në formularë nuk ndryshon asnjë cent. Formularët i dërgojmë në ministri. Të pika tjetër i patëm. Lëvizjet e mjeteve bëhen nga kategoria e shpenzimeve komunale 10,000€ dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve 8,500€, transferohen në kategorinë Mallra dhe shërbime, se kemi mungesë të mjeteve. Tani na kanë ardhur kërkesat për kompensimin e punëve publike të viteve të kaluara operatorëve ekonomik për kontratat e asaj kohe që kanë humbur si rezultat i inflacionit, janë 2 apo 3 kontrata që nuk kemi mjete në nën programin infrastrukturë rrugore 18,500€. Nevojë ka për subvencione dhe transfere, por ne në fillim të vitit i orientojmë nëpër drejtori.

z. Adnan Reka: Sa % të mjeteve jeni duke bërë transfer, se ne nuk kemi të dhëna ?

z. Bahri Selimi: Brenda shumës 15% nuk i vjen as 3% të mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, 7 Kundër, 4 Abstenime. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023/ Lënda: 01Nr. 400/01-27193/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 5 është hequr. Kalojmë në pikën 6.

6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;

Kërkesën e ka bërë me herët komuniteti, se në varrezat e Doganaj nuk ka më hapësirë për varreza. E hapi diskutimin:

z. Rustem Zenuni: Është mirë që është menduar lokacioni për varreza për Doganaj dhe Soponicë. Propozim im është, të rritet sipërfaqja për varreza për këto komunitete, në mënyrë që të ketë hapësirë për një kohë sa me të gjatë, që mos të ndodhë pas 20 viteve me ndarë përsëri lokacion për këtë qëllim dhe me u bërë varrezat në shumë lokacione.

z. Adnan Reka: Ne jemi për lejimin e hapësirës, ndërkaq nëse kërkohet me u rritur sipërfaqja qysh e propozoj Rustemi, kjo pikë duhet me u hequr dhe me dal me propozim vendim tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa është për sipërfaqen e kërkuar, nëse ka të interesuar edhe nga fshatrat tjera, drejtorja besoj se mundet me zgjeruar sipërfaqen, pasi ka hapësirë. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-27224/23.

7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë shkojmë me propozime konkrete nga subjekti politik me i madh, me përbërje e komisionit prej 7 anëtarëve:

z. Rustem Zenuni: Nga PDK, e propozojmë Fatmir Bunjaku.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nga LVV e propozojmë Agim Mani.

znj. Ardita Rrahmani: Nga LDK e propozojmë Arlinda Rakoci-Raka.

z. Ekrem Livoreka: Nga AAK e propozojmë Rabije Sallahi.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga NISMA: Agim Çaka.

Propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe u aprovuan njerëzi. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, në përbërje si vijon:

1. Kemal Murseli,	kryesues	KK
2. Fatmir Bunjaku	anëtar	KK
3. Agim Mani	anëtar	KK
4. Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	KK
5. Rabije Sallahi	anëtar	KK
6. Agim Çaka	anëtar	KK
7. Makfire Malsiu	anëtar	Zyra e Kryetarit/ Lënda: 01Nr. 60/01-27136/23.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Faleminderit drejtorit për informatën e përgatitur. Jemi në muajin tetor, uroj një vit të mirë shkollor. E kam diskutuar edhe në KPF se jemi të shqetësuar me rënien e numrit të nxënësve të gjimnazit dhe të SHMP, me çka ekziston mundësia që vitin vijues të bien numri nën tre shifrorë.

z. Agim Mani: Edhe për ne është shqetësuese rënia e numrit të nxënësve, ndërkaq duhet bërë politika lokale me mbajtje numrin e nxënësve që mos me shkuar në shkollim në komunat tjera, si Ferizaj. Këtë çështje unë e ndërlidhi me çështjen e transportit të nxënësve. Mendimi im është, t'iu bëhet kompensimi i transportit të nxënësve edhe nxënësve të gjimnazit sikurse atyre të SHMP, se nëse nxënësi nuk paguan transport, nuk besoj se shkon me mësuar në Ferizaj.

z. Adnan Reka: Në f.3 paragrafi 1, thuhet: një mësimdhënës të mësimit klasor dhe një psikolog për SHFMU “Idriz Seferi” në Bob me plotësim norme në QEAP “Agimi” në Kaçanik. A është fjala për një psikolog vetëm në Bob apo në “Idriz Seferi”. Nëse është një i tillë, unë punoj aty dhe nuk e kam pa asnjëherë. Nëse është fjala vetëm për Bob, atëherë të dimë që është vetëm për Bob.

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë dua të elaboroj një çështje për sigurimin e transportit të nxënësve dhe arsimtarëve të f. Kovaçec. Këtë çështje e kam ngritur në shtator tek organet përkatëse në komunë, dhe në mbledhjen e fundit të KPF, por ende nuk është zgjidhur kjo çështje. Si rezultat i kësaj po vuajnë nxënësit dhe prindërit e tyre. Për fshatrat me largësi, Gllaboçicë dhe fshatrat tjera, është bërë zgjidhje, ndërkaq në Kovaçec ende jo. Janë afër 60 nxënës që e kanë problem çështjen e mësim nxënies. Ka nxënës që nuk mund të vijnë edhe kushtet nga lëmit e ndryshme jashtë programit shkollor, për shkak të problemit të udhëtimit. Meqë jemi në këtë seancë, është me interes për nxënësit dhe prindërit së bashku me personelin arsimor nga ky fshat, të dëgjojnë drejtorin e DSHPE dhe drejtorin e DA se çka janë duke punuar në këtë drejtim.

z. Bashkim Luma: Në informatën e fillimit të vitit të ri shkollor, nuk janë cekur dy pozita të cilat janë liruar në shkollën e Gllaboçicës. Mungesa e transportit të nxënësve për 1 muaj, nuk është theksuar si problematikë, që është shqetësim i madh i banorëve atje. Është mirë drejtori me na treguar, kush e ka realizuar bazamentin e dëshmorit, Gafurr Luma? Shqetësuese është edhe mungesa e një librarie në komunë. Komuna duhet të merr veprime konkrete për një librari, që me ua mundësuar qytetarëve furnizimin me libra.

Kryesuesi i Kuvendit: Ajo që me shqetëson mua dhe banorët e f. Doganaj është, mungesa e kushteve për zhvillimin e mësim të shkollës. Gjendja në shkollën e Doganaj është e mjerueshme, objekti i ri ka mbetur në gjysmë, dhe nuk është investuar në objektin e vjetër me shpresë se kalojnë në objektin e ri. Unë kam biseduar me drejtorin e DA, kam kërkuar me biseduar edhe me ministrinë, se kontrata është e nënshkruar me ministrinë. Ndoshta në një të ardhme të afërt mundemi me u përballë me bojkotim të mësim nga ana e nxënësve dhe prindërve se nuk ka shkolla kushte elementare. Jemi dëshmitarë se vitin e kaluar është mbyllë shkolla nga institucioni, për shkak të insekteve dhe krimbave që janë shfaqë nga çatia në klasë. Unë bëjë thirrje nga këtu organeve edhe ministrisë që të merr hapa për me vazhduar realizimi i projektit, sepse gjendja në atë shkollë është shumë e vështirë. Kushdo që shkoni mund të vërtetoni dhe pajtoheni me këtë gjendje. Pa dashur me bërë politikë në këtë drejtim, ne kërkojmë me bërë realizim të projektit ashtu si është kontrata në afat sa me të shkurtër, sepse nxënësit në këtë fillim të ri shkollor është dashur të jenë në objekt të ri. Qysh po shihet edhe vitin vijues nuk do të përfundon objekti i ri shkollor, me këtë dinamikë të realizimit të projektit. Është mirë që të jemi me këmbëngulës edhe të ministria, që të realizohet projekti.

z. Adnan Reka: Pajtohem me këtë që e theksuat, praktika me ka mësuar, unë jam përballë me një kritikë që ka qenë investim komunal të shkollës në Kovaçec, larg me të keqe se ajo e shkollës në Doganaj, e cila me vonë ka përfunduar. Është shqetësuese për gjendjen e shkollës dhe duhet ecur këtë punë, por fatkeqësisht as niveli lokal nuk ka qenë në gjendje me të mirë të detyrës për çështjen e shkollës.

z. Zahir Doda: Shqetësimi që u ngrit për rënien e numrit të nxënësve, është shqetësim i të gjithëve. Këtë vit është mbyllur një shkollë, në prag të mbylljes janë edhe dy shkolla tjera për shkak të rënies së numrit të nxënësve. Rënie të numrit të nxënësve nuk ka vetëm në shkolla të mesme, por ka edhe në shkollat fillore, ndërkaq në Kaçanik të Vjetër shkolla ka ngritje të numrit të nxënësve, ku ruhet një stabilitet dhe në qendër, ndërkaq nga viti i ri pritet me pasur rënie edhe me të madhe, shpresoj të mos ndodhin. Të transporti i nxënësve, jemi munduar, por nuk ka mundësi buxhetore me mbuluar transporti për të gjithë nxënësit e shkollës së mesme, duhet me lënë shumë punë keq me prioritet. Deri këtë vit pikat me të larta janë subvencionuar 50%. Këtë vit në konsultim me kryetarin kemi marrë vendim që zonat me të larta, Ivajë, Gllloboçicë, Strazhë, i paguaj 100% edhe në gjimnaz edhe SHMP, kurse të SHMP i është dhënë prioritet se është edhe në Strategjinë e arsimit në nivel vendi me iu dhënë prioritet shkollave profesionale, sepse në gjimnaz grumbullohet numër me i madh i nxënësve që nuk ka mundësi me gjetur tregun. Të pyetja e Adnanit, numrin e psikologëve në nivel komunal e kam plotësuar, 6 duhet me qenë në 1000 nxënës 1, e kam plotësuar, 6 janë në sistem. Gjendjen e kam gjetur sistemin me 1, tani janë 10 në shërbim profesional, duke përfshirë psikolog, pedagog etj. norma kjo që na lejohet. Çdo shkollë thirret me emrin e shkollës amë. Për shkollën “Idriz Sefer” është 1 psikologe e pranuar me konkurs, ndërkaq dihet se shkolla i ka edhe paralelet e ndara, menaxhmenti i shkollës merret me orarin, a ka qenë në paralelet e ndara a jo nuk e di. Për transportin në Kovaçec, është çështje që duhet ta zgjedhë DSHPE, ka pasur thirrje publike, por nuk ka mundur me gjetur. Për shkak të distancës që ka, unë si drejtor i DA nuk e kam obligim ligjor me iu bërë pagesë, kështu nuk jam marrë me këtë çështje, se shkolla është afër dhe nuk bëhet pagesa e transportit me qenë edhe të fillores nxënësit. Të pyetja e Bashkimit, zakonisht me transferin e punëtorëve, merret punëdhënësi, është e drejtë ligjore, janë 530 punëtorë, janë 2 punëtorë që janë transferuar, nuk është pasqyruar në asnjërin raport. Të transporti i nxënësve në Gllloboçicë, kam bërë përpjekje, nuk kam mundur me bërë zgjidhje për 1 muaj ditë, kjo është dashur me u shënuar në raport, megjithëse transporti është obligim i familjes, se nuk kemi obligim ligjor, por obligim moral, se janë fëmijët tanë. Nxënësit e Kotlinës i bartim me transport të komunës dhe asnjë ditë nuk e kanë humbur asnjë orë me fajin tonë. Kam bërë përpjekje me zgjidhur problemin, kam shkuar me propozimin që t’iu mbulohen shpenzimet edhe për gjimnaz dhe SHMP. Rregullimi i bustit, është në kuadër të projektit të meremetimit të shkollave, është e njëjta kompani që punon në “Emin Duraku”, në kulmin në shkollën e Kovaçecit, se mjetet janë nga mallrat dhe shërbimet. Kompania se kënd e ka marrë nën kontraktues, kam qenë 2 herë atje, e kam pa se është një vendas i tyre, kam kërkuar që puna të bëhet sa me mirë, janë të kënaqur edhe familjarët me punën që po bëhet deri tani. Libraria është çështje biznesi, si komunë nuk kemi mundësi ne me subvencionuar, ndërkaq biblioteka është çështje tjetër. Unë e kam pasur shqetësimin kur është marrë vendimi që librat duhet me u blerë, e kam përmendur në TV të ndryshme që na mungon libraria. Me konkurs ka qenë 3 ditë në shkollë, 2 ditë në çerdhe, 1 ditë në Elezaj një ditë në Bajnicë në paralele të ndara.

znj. Kadrije Lika-Troni: Faleminderit drejtor për përgjigjen, ankesat e prindërve i adresova këtu. Si anëtare e KK ndihem e shqetësuar, për transportin që mungon në Kovaçe-Kaçanik, duke marrë parasysh që secili prind, secilin fëmijë e trajton si nxënës, epiteti i nxënësve është për krejt prindërit i njëjtë, si për prindërit e Gllloboçicës, Kovaçecit dhe fshatrave tjera. Unë me gëzon fakti që f. Gllloboçicë ka arritur me iu paguar shpenzimet e transportit, se është pika me e lartë, ndërkaq ne në Kovaçec nuk po kërkojmë mbulimin e shpenzimeve, por me siguruar transport për nxënësit. Ne shqetësimet e prindërve kemi të drejtë me i adresuar çdo herë dhe janë duke na ndjekur live këtu, dhe nuk do të ndalem me këtë, për derisa shkolla e Korblicit e

kanë zgjidhur këtë çështje, ne ende e kemi problem dhe nuk e di qysh kanë me korre sukses ata nxënës.

z. Zahir Doda: Nuk e kam obligim ligjor me siguruar çështjen e transportit të nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit: Vijat e transportit i ndan DSHPE.

znj. Kadrije Lika-Troni: Aspekti i nxënësve në mësim nxënie është problem që duhet me u shqetësuar.

z. Ramadush Osmani: Ne jemi duke u ndjekur live, Përgjigjen zyrtare të cilën ia kam dërguar zonjës në fjalë me email, mundet me lexuar para kamerave. Dy herë kam bërë shpallje publike, operatorët e shikojnë interesin e tyre, ky është biznes. Unë nuk mundem me i subvencionuar, kështu që nuk ka pasur të interesuar me operuar dhe nuk mundem me obliguar askënd me operuar.

z. Bashkim Luma: Në një intervistë në TV Dukagjini drejtori e ka potencuar çështjen e transportit të nxënësve si zgjidhje të përkohshme, por kjo zgjidhja e përkohshme ka mundur të bëhet edhe një muaj me herët, nga data 1 shtator. Është mirë që përfaqësuesve që i keni në Glloboçicë me iu dhënë informata të sakta, që ata mos me dezinformuar atje. Ata japim informacionin për zgjidhje afatgjate, ndërkaq këtu e kemi informatën për zgjidhje të përkohshme. Të pozitat e mësimdhënësve, në f. Glloboçicë nuk janë bërë transfere, ata janë të punësuar për herë të parë në drejtori në mësim klasor. Të busti i heroit Gafurr Luma, kompania është ajo që e theksuat, por ia ka dhënë punën një kompanie tjetër e cila nuk ka biznes. Është një i atij fshati që e shfrytëzon një kontratë të tillë, për përfitime personale, se ai nuk ka biznes dhe nuk është kompetent për atë punë, ndërkaq shumë mirë që po punohet busti i heroit Gafurr Luma, se ka qenë në gjendje të mjerueshme. Të çështja e librarisë, është mirë me biseduar me ndonjë librari që me ia krijuar kushtet të shtëpia e kulturës ka ndonjë hapësirë të vogël sa me i plotësuar kushtet e biznesit.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundesh me ia dhënë një hapësirë një biznesi privat në shtëpinë e kulturës, ndërkaq ky tjetri me paguar qiranë. Këto janë çështje biznesi të cilat ata i parashohin. Kushdo që ka interesim me bërë një biznes të tillë, është i lirë, nuk e ka asnjë pengesë nga askush, se kjo është çështje e përfitimit. Librari ka pasur me herët, por në momentin që librat janë dhënë falas, e kanë pa jo të leverdishme këtë biznes. Tani shumica e marketeve të mëdha, si Viva, ETC, e kanë një pjesë të materialit të librave shkollor. Sivjet është dashur me i blerë librat, kjo ka ndodhë pas disa viteve, nëse vazhdon kështu, ndoshta dikush e sheh të nevojshme me hap një biznes librarie.

z. Zahir Doda: Çështja e zgjidhjes së përkohshme të transportit, është e përkohshme derisa të kryhen procedurat e tenderimit për afatgjatë. Ata nuk mbeten asnjë ditë pa transport dhe kjo nuk është çështje mashtrimi. Pse nuk është bërë menjëherë në shtator, nuk ka pasur vijë të regjistruar ky që ka qenë i interesuar. Ky ka ardhur pas dy jave si qytetar, pasi ka filluar mësimi dhe dy javë kanë procedura deri sa e ka regjistruar biznesin, pastaj iu ka dhënë vija, se edhe unë kisha dashur nga fillimi dhe nuk kishte pas vend për kritika. Të kërkesa tjetër, e sqaroj kryesuesi, unë nuk mundem me caktuar kompaninë private kënd e merr aty me punuar, mua me intereson a është duke u kryer puna sipas projektit. Puna është kryer sipas projektit, familjarët, udhëheqja e shkollës dhe punëtorët që janë aty janë të kënaqur.

z. Bashkim Luma: Ju e keni përgjegjësinë për çështjen e transportit dhe është dashur me realizuar atë çështje, se kjo nuk shkon me atë se a donë apo jo dhe kjo është realizuar me një muaj vonesë. Administratori në një intervistë e ka cekur këtë çështje, pastaj ka dalë kundër fjalëve të veta. Ndërtimi i bustit, unë e di që ju nuk munden me caktuar se cila kompani me vendosë ato pllaka, por çështja është se ata persona nuk e kanë profesion, dhe kualiteti shihet pas një kohe.

Kryesuesi i Kuvendit: Të çështja e transportit, nuk ka qenë në tender 1-2 herë nuk ka pasur ofertues. Një çështje që nuk e kemi obligim ligjor, është problem me vepruar jashtë procedurave, se me pasur obligim ligjor, drejtori nuk ka të drejtë me pritë asnjë ditë. Të nxënësit e shkollave të mesme, është obligim moral, për shkak të terrenit, por duhet me u bërë zgjidhja

dhe është bërë pak me vonesë për arsyet e cekura. Të ndërtimi i bustit, është kompania që mban përgjegjësi a është duke u bërë puna mirë apo jo. DA ka punë me kompaninë.

z. Bashkim Luma: Inspektorati duhet me shkuar atje me pa punën.

z. Naim Beça: Sa km. është obligim ligjor që komuna me ua siguruar transportin nxënësve?

z. Zahir Doda: Mbi 4 km.

z. Selajdi Troni: Për f. Kovaçec, unë kam pyetur për çështjen e transportit, kanë qenë 3 operatorë, që kanë punuar njëri pas tjetrit, në fund edhe i treti e ka ndërprerë se nuk ka pasur llogari. Ndërkaq pasiguri të nxënësve ka, gjendja nuk është e mirë, por nuk mundesh me obliguar askënd pa e pasur llogarinë e vet, kjo mbetet çështje e hapur.

z. Rustem Zenuni: Kur diskutojmë, duhet dërguar mesazh se jemi duke u angazhuar për me zgjidhur një problem, e jo nëpërmjet fjalimeve me shprehur atë çka është duke u penguar se Bashkimi ndoshta ka pasur dëshirë me dështuar transporti i nxënësve në Gllloboçicë, ndoshta është duke u penguar edhe busti që është duke u ndërtuar aty, unë këtë nuk po e kuptoj.

z. Bashkim Luma: Kur ke problem me dhëmbin Rustem, ti nuk shkon të ujësjellësi. Edhe projektin e bustit duhet me punuar dikush që është profesionist i fushës.

z. Agim Çaka: Angazhimi i drejtorit të DA dhe drejtorëve të shkollave si pikësynim e kanë suksesin e nxënësve. Për këtë arsye, unë kërkoja me ndryshuar renditjen, se ne po flasim për fillimin e vitit të ri shkollor, pa e ditur se çka ka ndodhur në përfundim të vitit shkollor, me pa se a ka pasur sukses apo jo viti i përfunduar shkollor, se krejt kjo ndërlidhet me infrastrukturën e shkollave, numrin dhe kualitetin e mësimdhënësve, seriozitetin e tyre. Rënia e numrit të nxënësve në shkolla që u potencua, edhe për mua është shqetësuese. Cilat shkolla ka mundësi me u mbyllur ? A ka ndonjë shkollë që është mbyllë dhe çka do të bëhet me ato shkolla ? Për këtë arsye është mirë me pas planifikime, se u tha që është rritur numri i nxënësve në shkollën e Kaçanikut të Vjetër, kjo është si rezultat i shpërnguljes së banorëve nga Kotlina etj. por lëvizjet e qytetarëve duhet me u përcjellë nga DA, DSHMS dhe me bërë planifikimin. Për mua është me rëndësi infrastruktura me qenë gati në fillim të vitit shkollor, niveli i kualitetit të mësimdhënësve etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

Njoftohet

Me Aktivitetin e zhvilluar të drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024, në bazë të dhënave të prezantuar si në Informatë / Lënda: 04/610/01-24178/23.

9. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bashkim Luma: Në këtë Informatë nuk është potencuar donacioni në shkollën “Gafurr Luma” në Gllloboçicë. Drejtori pati thënë se do t’evidentohen në informatën e radhës, por nuk janë evidentuar. Drejtori i DA pas çdo përfundimi të vitit shkollor e përmend ngritjen e cilësisë në arsim. E pyes drejtorin si keni me rritur cilësinë në arsim ku në mesin e kandidatëve kur punëson kandidatë me notë mesatare nën notën 7, ndërkaq i lënë anash kandidatët me mesatare mbi notën 8 dhe pranimin e kandidatëve 6 vite para pensionimit, ndërkaq i anashkalojnë kandidatët që janë në moshë të re, kjo s’ka logjikë. A duhet drejtor që detyrimisht që kandidaten që zgjidhen me punuar në shkolla, të jenë militantë.

z. Zahir Doda: Me tepër Bashkimi dha komente. Puna e donacionit, nuk është donacion i madh, ndoshta është dashur para kësaj të jenë i evidentuar. Të kandidatët jeni adresuar gabim, ne menaxhojmë me ata që na vijnë si emra dhe mundohem me i përcjellë dhe ia kam arritur. Vlerësimet që i bënë janë ekip prej 5 vetave, janë procedurat, ka auditor që i përcjellin ato procedura. Ligjërisht është çdo gjë në rregull.

z. Bashkim Luma: Nënshkrimi është i juaji aty drejtor dhe i kryetarit. Ju duhet me dhënë përgjigje në pyetjet që janë shumë logjike, por në rregull ashtu mendoni që është me e mira për cilësinë në arsim dhe ashtu keni vendosur.

z. Zahir Doda: Ku e keni pa atë nënshkrim që nënshkruan drejtori?

z. Bashkim Luma: Konkursat të cilat hapen, kush i hap konkursat?

z. Zahir Doda: Konkursat i hapë Zyra e personelit.

z. Bashkim Luma: Në rregull atëherë, kërkoj falje.

Kryesuesi i Kuvendit: Konkursat i hapë Zyra e Personelit, përpara i ka hapur Drejtoria e Arsimit, ndërkaq tani këto kompetenca i kanë kaluar Zyrës së Personelit. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

Njoftohet

Me Aktivitetin e zhvilluar të drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023 në bazë të dhënave të prezantuar si në Informatë / Lënda: 04/610/01-27191/23.

10. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP”.

Kryesuesi i Kuvendit: Kryetari i Komunës e ka formuar një komision për me shikuar gjendjen e pronave komunale që janë dhënë në shfrytëzim. Raportet janë bukur voluminoze, besoj se i keni trajtuar. Sa e kam pa unë, komisioni, ka dhënë një pasqyrë të saktë. E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Po e përsërisim atë që kemi thënë atëherë. Nuk jemi kundër investitorëve serioz, por jemi kundër shkeljeve ligjore dhe manipulimin me ofertues. Kam disa pyetje për kryetarin lidhur me këtë kontratë: 1. Pse deri tani nuk i keni raportuar KK në baza të rregullta 6 mujore për planin dinamik, ashtu si iu obligon ligji? 2. A ka përfutur të hyra financiare komuna nga kjo kontratë siç e parasheh ligji? 3. Pse e keni lejuar ndërtimin e tre objekteve pa leje ndërtimore?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi : Meqë bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale për 99 vjet, komisioni ka bërë vlerësimin e tyre, ato pyetje që me adresohen: 1. Kontratat janë dhënë në fund të vitit 2019 dhe fillim të vitit 2020 kur ishte kohë pandemie, me arsyetimin duke iu dhënë mundësi kompanive për shkak të situatës së krijuar, e kam pa të arsyeshme mos të formoj komision, se duhet paraprakisht me dalë një komision me i verifikuar, me iu dhënë vërejtje siç e kemi krijuar tani dhe raporti me ardhur në KK për me marrë rekomandimin e KK sesi me vepruar me këto kompani. Pjesa tjetër morale, për mos me u ngutur që me thënë kryetari veç ua dha pronat e ua mori, iu kemi krijuar mundësinë kompanive me pa sa e kanë seriozitetin e punimeve në këtë drejtim. Pandemia zyrtarisht ende nuk ka përfunduar, unë në fund të vitit 2022 kur ka qenë kulmi i pandemisë kam formuar komisionin për vlerësim, dhe komisioni për shkak se ka dashur me bërë raportin sa me të saktë, raporti ka qenë shumë real. Me vërejtjet që kemi dërguar në 3 muajt e fundit, kemi marrë një raport tjetër që se nuk kanë lëvizë, kjo është arsyeja që është stërzgatur raporti në KK, për me pa seriozitetin e kompanive, se shumica e kompanive janë arsyetuar si rezultat i pandemisë kanë ngecë investimet e investitorëve, apo shkaqe të ndryshme. 2. Komuna i ka ligjet dhe rregullat që përcaktojnë që epët prona për 99 vite pa pagesë, pjesa tjetër si çdo lloj biznesi edhe këto kompani i nënshtrohen atyre. Sa ka pas përfitime, duhet bërë pyetje e veçantë, duhet pa të DUKMM taksat që janë vjelë nga ata. 3. Për pyetjet e tretë, me kompetentë është drejtori i DUKMM, me sqaruar se cilat janë arsyet që nuk kanë leje ndërtimi objektet ndërtimore.

z. Adnan Reka: 1. Vit pandemie ka qenë viti 2020. Po të ishte formuar komisionin dhe kishte dal në vendngjarje, këto defekte ligjore do të ishin me të vogla, planin operativ të punës operatori e kishte zhvilluar me mirë, se tani që është formuar komisioni, kanë filluar me ecur punët pak me përpara. 2. Për të hyrat, të obligon ligji, neni 12 i Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe këmbim prone thotë: ”Të hyrat financiare të komunës që realizohen nga dhënia në shfrytëzim e pronës, konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal”. Nuk po flasim për përfitimin

ekonomik se ligji është i qartë, por për përfitimin financiar. 3. Të objektet pa leje, komisioni ka konstatuar për objektet pa leje, jo ne. Nëse komisioni ka konstatuar, e ju deri me tani nuk i keni ditur, unë kam shumë dilema.

z. Agim Çaka: Është e vërtetë se ne kemi kërkuar raport lidhur me pronat që janë dhënë në shfrytëzim, me pa se ku janë me dinamikën e zhvillimit të punimeve dhe realizimin e projekteve. Unë të ky rast nuk po shoh asgjë kaluese, përjashtoj punën e komisionit që e ka kryer punën e vet dhe ka vlerësuar gjendjen në terren. Sipas kësaj që po e shoh, komisioni gjatë inspektimit, ka kërkuar dëshmi lidhur me investimet e bëra, mirëpo përgjegjësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi. Përgjegjësi tjetër që i ka konstatuar komisioni janë: çështja e punëtorëve, leja e ndërtimit. Çka mundemi ne me bërë në këtë rast, cilat janë hapat tonë si KK dhe si komunë, cilat janë dispozitat ligjore për veprime të mëtejme.? Për këtë arsye është tërhequr vërejtja se kujt po ia japim pronën në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ligji është i qartë, përcakton qartë kushtet e dhënies dhe pasojat nëse nuk investohet në atë parcelë. Ne nuk kemi asgjë çka me bërë këtu, vetëm duhet zbatuar ligjin, aty ku nuk është investuar, duhet kthehet prona komunës. Mbetet komisioni të vlerësoj edhe një kohë se a gjënë hapësirë me ia vazhduar, se nuk e di se a i plotësojnë kushtet ligjore. Pas kësaj mbledhje secili operator besoj se ka me qenë pak me i vetëdijshëm se prona mund t'i merret, vjen propozimi në KK nga drejtoria për shfuqizim të vendimit dhe kontratës nëse nuk i ka përmbushur kushtet e përcaktuara me kontratë. Kohën e kanë përcaktuar ata vet për përmbushje të planit dinamik, planin e biznesit e kanë bërë vet, vlerën e investimeve, numrin e punëtorëve e kanë dhënë vet, ne iu kemi besuar, ata që nuk i kanë përmbushur i bartin vet pasojat.

z. Qamil Stagova: Leja e ndërtimit e cila u përmend, këta kanë leje ndërtimi, përpos kompanisë “Kaçinka” L.L.C. Kompania ‘Muja’ OP në ndërkohë e ka marrë lejen ndërtimore. Inspektori e shikon a është duke punuar me leje apo jo, unë nuk kam lidhje me inspektoratin.

z. Adnan Reka: Komisioni ka konstatuar se kompania nuk ka leje ndërtimore, ndërkaq drejtori thotë se ka marrë leje në ndërkohë, dhe ju e lini me u zhvilluar një veprimtari pa leje. Ku është arsyeja, se ai duhet me pas një arsye që nuk ka leje dhe dëmin financiarë që ia bënë komunës? Ju drejtor po thoni se nuk jam përgjegjës, atëherë i drejtohem kryetarit se çka bënë inspektori?

Kryetari i Komunës: Unë nuk e kam ditur që nuk ka leje ndërtimore, nuk po e përjashtoj mundësinë që lejen e ka marrë ndërkohë. Unë nuk kam dalë me inspektuar se kur e ka përfunduar pllakën. Është në përgjegjësi të inspektoratit me bërë një raport kryetarit dhe DUKMM.

z. Adnan Reka: Qasja ndaj pronës komunale, për objektet që nuk kanë leje, me një arsyetim kaq të lehtë dhe të thjeshtë, nuk e di qysh po menaxhohet nga komuna, që çdokush të ndërton çka të donë, në fund epët një arsyetim?

z. Qamil Stagova: Ju Adnan një objekt e gjeni pa leje, ndërkaq thoni se krejt ndërtimet në komunën e Kaçanikut ndërtohen pa leje.

z. Adnan Reka: Pasi nuk po e pranon drejtor, shikojmë kur të dalim të pikat tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Mesazhi po i përcillet edhe Ekzekutivit. Ata të cilët nuk kanë filluar ende me punuar, t'i kenë parasysh masat që duhet marrë komuna në raport me ligjin që i obligon ndaj pronave që nuk i kanë realizuar kontratën që e kanë nënshkruar vet. Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-38954/2019 të datës 09.12.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katër dhjetë (40) vjet me Vendim të KK, pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale P-70917021-00217-3 në Zonën Kadastrale Gërlicë e Epërme, sipërfaqja e aprovuar 00.42.18ha dhe në Parcelën kadastrale P-70917026-00124-1 në Zonën kadastrale Doganaj, sipërfaqja e aprovuar 00.13.56ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër “MUJA” O.P. me përfaqësuesin Muhamet Zenuni Operatorit Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7152/23.

11.Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ne po i dimë pronat që janë dhënë në shfrytëzim, por nuk po e dimë përmbajtjen e kontratës, se a i është thënë operatorit kur është nënshkruar kontrata, se për 99 vite keni me i kryer këto punë, apo është i përcaktuar me planin dinamik?

Kryetari i Komunës: Planin dinamik nuk e kemi përcaktuar ne, ata e kanë bërë vet planin dinamik, dhe po e di ku po donë me dalë. Planin dinamik e përcakton kompania, kurse dhënia në shfrytëzim është për 99 vjet.

z. Agim Mani: Unë jam i qartë se prona është dhënë për 99 vjet, kontrata është nënshkruar në vitin 2019 në dhjetor nga Kryetari i Komunës Besim Ilazi si autoritet kontraktues dhe Mevlud Zharku- biznes operues. Plani dinamik ka qenë me u kryer brenda 12 muajve, nuk është kryer. Një arsyetim që u dha me herët për shkaqe pandemie, nuk është arsyetim, se komisioni duke respektuar masa ka pasur mundësi me dalë në inspektim. Në anën tjetër pse i jepni pronat në shfrytëzim në kohë pandemie, kur nuk mund ti menaxhoni. Neglizhenca e juaj besoj, mos transparenca me dhënë llogari, ka ardhur deri këtu. Ashtu si e potencoj edhe Adnani, me i pas marrë veprimet me kohë, edhe biznesi kishte me qenë më serioz dhe puna kishte shkuar më mirë, nuk kishte ngecë. Në bazë të vlerësimit të komisionit, biznesi është bartur të pronari SHPK “German Beton”. A jeni në dijeni si nënshkruet i kontratës? Çka keni me bërë me rekomandimet e komisionit? E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nuk mund të bartet në shfrytëzim të personit të tretë, këtë nuk e lejon ligji.

z. Adnan Reka: Në këtë pikë të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, unë mendoj se ka shumë me tepër shkelje të rënda sesa në pikët tjera: 1. Është bërë ndryshimi i pronarit, që bien ndeshë me kontratën. 2. Mosrespektimi i planit dinamik. 3. Mosrespektimi i planit të biznesit. 4. Ndërtimet e objekteve pa leje; restoranti dhe autolarjes që nuk mundeni me i mohuar që nuk i keni pa, si e theksuat të operatori tjetër. Këto janë disa shkelje të ofertuesit, ndërsa shkeljet e juaja si autoritet kontraktues janë: Mbikëqyrja e kontratës, Mos raportimi 6 mujor në KK, Dëmi i buxhetit të lejet dhe zbatimi i taksave për pronën, janë shkelje direkt që janë bërë. Janë bërë shpërndarje miliona kubik e betonit nga kompania në pandemi e pa pandemi. Kemi një varg shkeljeve ligjore nga dy palët kontraktuese dhe në fund asgjë. Unë kam dyshime të mëdha për këtë çështje. Pyetja është: Çka do të bëni tutje? A ka ndonjë padi penale për kontraktuesin, se ka tepër shkelje. Në planin e biznesit ka paraqitur tjetër beton që ka me u bërë, ndërkaq tjetër, në certifikatën e regjistrimit të biznesit, dhe se ka shkuar askush. Tani pas disa viteve kur kërkesa për beton ka përfunduar, atëherë me lehtësinë me të madhe me ia marrë pronën, nëse ia marrim. Besoj se përgjegjësia bien të dy palët kontraktuese.

Kryetari i Komunës: Adnan, sa i përket përgjegjësisë penale, janë organet që merren me këto punë për çdo shkelje që bëhet. Unë e potencova se nënshkrimi i kontratave është bërë në dhjetor 2019, procedura me marrë lejen e ndërtimit është nga 6 muaj. Në shkurt 2020 ka filluar pandemia që ka paralizuar gjithçka. Një pjesë e bizneseve dhe ky biznes e kanë ngritur shqetësimin se nuk kanë mundur me transportuar një fabrikë nga Norvegjia apo nuk e di nga ku, prej 3 milion euro, kjo ka qenë jo me shkrim, por me gojë, ishte obligim imi moral me prolonguar raportin për shkak të situatës së krijuar me raportuar në KK në çdo 6 muaj

se ajo është përgjegjësi ligjore dhe morale e imja, atë përgjegjësi e barti, pjesa tjetër ishte përgjegjësi morale, për me mundur me iu dhënë mundësi bizneseve mos me shfrytëzuar kohën, në kohën e pandemisë kur nuk ka funksionuar asgjë. Të njëjtën gjë e kam bërë për 2 vite, ndërkaq pas 2 viteve është formuar komisioni për me vlerësuar gjendjen dhe me më dhënë rekomandime qysh e parasheh rregullorja deri në këtë moment. Sa i përket ndërrimit të pronarit, në raportin e parë të komisionit thuhet se ka ndërrim të pronarit, në raportin e dytë të komisionit thuhet se nuk ka ndërrim pronarit. Kjo duhet të vërtetohet se a ka apo nuk ka ndërrim të pronarit? A është tërheq pronari që e ka bërë një kërkesë të tillë apo jo, ky biznes është i regjistruar me të njëjtin pronar që e ka bërë kërkesën. Pjesën e lejeve, nuk e kam marrë obligim me i pyetur, se është inspektorati që raporton për leje dhe ndërtime. Secili zyrtar mban përgjegjësi për punën e vet. Në momentin që një zyrtar e sheh se është punuar pa leje, ka obligim me zbatuar ligjin. Nëse kryetari ndërhyrë, atëherë ai do të ketë me shkrim se është penguar për zbatimin e ligjit. Përgjegjësitë janë të ndara, unë nuk i iki asnjë përgjegjësie.

z. Adnan Reka: Pyetje direkt për kryetarin; A ka paguar ndonjë cent për tokën që e ka marrë në shfrytëzim?

Kryetari i Komunës: Toka në shfrytëzim epët për 99 vjet, pa asnjë cent. Ligji e mundëson, jo kryetari i komunës, kurse pjesa tjetër, taksat i nënshtrohen si çdo lloj biznesi tjetër, sipas ligjeve në fuqi.

z. Adnan Reka: Unë po i referohem nenit 12 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe këmbim prone: "Të hyrat financiare të komunës që realizohen nga dhënia në shfrytëzim e pronës, konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal".

Kryetari i Komunës: Nuk e di Adnan a e keni lexuar rregulloren tjetër se kush taksohen? Kjo është për dhënien në shfrytëzim me pak se 1 vit, ku përcakton me m² sesa pagan, për atë ne e shfrytëzojmë atë të drejtë. Kemi dhënë edhe prona për 15 vjet, ku përcaktohet me m² sesa paguhet, por jo për pronat që epën për 40 dhe 99 vjet.

Kryesuesi i Kuvendit: Për prona e dhënies komunale në shfrytëzim, ligji e parasheh që pronat mos të epën me vlerë të caktuar monetare, se po të ishte ashtu, atëherë kusht dhe kriter do të ishte çmimi me i lartë. Kusht dhe kriter është vlera e investimeve, numri i punëtorëve, përfitimi ekonomik i komunës, e jo çmimi. Vlerat monetare që po thoni ju, është e vërtetë ajo që po thoni, por këto kanë të bëjnë me taksat që mbliidhen nga ai biznes, leja ndërtimore, tatimi në pronë dhe taksat tjera, ato mjete duhet të shpenzohen sipas ligjit për financat publike lokale.

z. Adnan Reka: Faleminderit kryesues për tentativën me sqaruar për me komentuar ligjin. Unë nuk po dua me komentuar ligjin, unë po e citoj ligjin si është shkruar, dhe këtu nuk është e përcaktuar për sa vjet. Për mua prona komunale është e njëjtë si për 1 vjet si për 99 vjet, nuk ka specifikë. Në rregull, e imja është me bërë pyetje, ndërkaq për të tjera merret dikush tjetër. Të leja ndërtimore, keni lëshuar leje pa asnjë dokument.

Kryetari i Komunës: E arsyetova me herët se në Kaçanik janë ndërtuar nja 10 mijë shtëpi e banesa. Unë nuk merrem me lejet, është inspektorati që merret me këto punë. Inspektorati i drejtohet drejtorisë përkatëse, ndërsa kryetari nuk merr vendim a i lëshohet dikujt leje apo jo.

z. Adnan Reka: Kryetar, ai iu ka pyetur juve në mënyrë specifike dhe të ka bërë të qartë për çfarë leje është fjala. Ti e din, dhe nëse thoni se nuk e di, të lexoj unë çfarë leje është kërkuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj mos me dal jashtë teme.

z. Adnan Reka: Në temë jemi. Pyetja është për kryetarin: Kur iu pyet autoriteti zyrtar, Kur lëshohet një leje ndërtimore? Cila është përgjigja? Nëse ju konstatoni se është një leje në këtë kohë, cili është veprimi i juaj?

Kryetari i Komunës: Përgjigjen unë ia kthej drejtorit të urbanizmit, atë përgjigje e jep drejtori, se unë nuk jep leje. Ajo është kompetencë e kryetarit, nuk kam nevojë me t'u përgjigjur.

Kërkesat adresohen me shkrim, përgjigjet i merrni me shkrim. Këto janë pyetje që i adresohen drejtorit të urbanizmit.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj mos me dalë jashtë rendit të punës.

z. Adnan Reka: Brenda rendit të ditës jemi, këtu është fjala për debat parlamentar.

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj një pauzë 5 minuta, me qëllim të relaksimit dhe me i kontribuar stabilitetit të debatit.

z. Agim Çaka: Për mua si anëtar i KK është shumë me rëndësi që raportet që i kemi kërkuar, na janë ofruar. E dyta, është me rëndësi për mua me ditur në këtë rast ka shkelje, e cila është konstatuar komisioni i formuar nga komuna. Unë kërkoj që aty ku ka shkelje, janë procedurat tjera që duhet me u ndjekur. E kam një vërejtje për ekzekutivin: Apo e shihni se operatorët nuk po punojnë si duhet. Shqetësimi ynë po del se ka qenë me vend kur është dhënë prona në shfrytëzim, kemi thënë me pasur kujdes se kujt po ia japim pronën dhe me përcjellë punën e tyre. Ky rast është më skandaloz, se pronën e ka marrë në shfrytëzim nga komuna dhe ia ka dhënë dikujt tjetër. Ai tjetri nuk kishte bërë asgjë, të shohim për këto tjerat në vijim.

z. Rrustem Zenuni: Kryesues, në cilësi të shefit të grupit të PDK, kërkoj me u zbatua Rregullorja e punës së KK nga secili nga ne kushdo qoftë, se nuk po e kontrollojmë sa duhet vetën tonë dhe po dalim nga vetvetja. Secili që shkel rregulloren e i kalon krejt limitet, me u përjashtuar nga seanca, se nuk mundem me vazhduar në këtë formë diskutimin e seancave.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-39284/2019 të datës 12.12.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për nëntëdhjetenëntë (99) vjet me Vendim të KK, pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale Nr. P-70917086-01407-0 në vendin e quajtur Çardak Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, sipërfaqja e aprovuar 02.59.30ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër të Mevlud Zharku, me Nr. personal 1500027319, ID 0423468 të lëshuar me 26.11.2015 nga MPB -Republika e Kosovës, Kuvendi i Komunës,

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr.104/02-7153/23.

12. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bashkim Luma: Sa i përket kësaj kontrate të nënshkruar me 25.06.2021, komisioni për mbikëqyrje të realizimit të kontratës e ka ofruar raportin me 27.01.2023. Deri me tani sipas konstatimit të komisionit, ofertuesi nuk e ka përmbushur planin e biznesit të cilin vet e ka ndarë në 3 faza. Faza 1, komisioni ka konstatuar se plani ka shkuar në rregull, ka zgjatë 3 muaj. Faza 2, transporti i makinave punuese dhe montimi i tyre, nuk është realizuar sipas planit 6 muaj, rrjedhimisht. Faza 3 nuk është përmbushur në mungesë të makinave punuese, nuk kanë mundur me u punësuar njerëzit. Tjetra, kryetari ka marrë vendim që në afat prej 3 muaj shtesë të bëjë realizimin e kontratës të nënshkruar ashtu si e ceka me herët. Ofertuesit iu ka dhënë një mundësi 3 muaj, pastaj në raportin tjetër me 26.04.2023 investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tij në tërësi dhe përsëri iu kanë dhënë edhe 3 muaj për me përmbushur planin e biznesit. Sa muaj keni të drejtë ligjor t’i jepet afat nga 3 muaj?

Kryetari i Komunës: Ku ta kemi fatin që të kemi bizneset tjera serioze si është kjo kompani që ua kemi dhënë pronat në shfrytëzim. Sa për informim, raporti është para 4 muajve, kompania veç e ka filluar montimin e pajisjeve –makinave.

z. Bashkim Luma: Besoj se është shumë serioz, por në bazë të asaj që ai ka ofertua, e ka pasur me përmbushur planin për 1 vit dhe të filloj punën, nuk e ka realizua, arsyet nuk i di.

Kryetari i Komunës: Bashkim, unë e potencova, ku të kishim fatin të kishim edhe bizneset tjera sikur ky, dhe ju po e bëni alarmante për 2-3 muaj vonesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur jemi të ky biznes, jemi dëshmitarë të asaj çka ka punuar, çdo kush që kalon atypari ka me pa sa ka investuar. Çka ka brenda nuk e di, por pamja nga jashtë shihet me sy, ka qenë komisioni, prodhimtaria është e mirë, e ka tregun e jashtëm të plasmanit. Bizneset kanë pasur ngecje në këtë kohë si rezultat i pandemisë, lufta në Ukrainë e bllokoj pak ecurinë e bizneseve. Aty ku ka synim të punës, jam për me iu dhënë afat kohor, aty ku nuk ka është diçka tjetër. Veprimtarinë e ka zhvilluar ashtu siç e ka paraparë në plan edhe komisioni e ka vlerësuar ashtu.

z. Adnan Reka: Edhe të tjerët kanë filluar në këtë formë, por në fund e pamë rastin që nuk ka vazhduar mirë dhe kryetari nuk i ka ndërprerë punën.

Kryetari i Komunës: Kërkoj falje që e përgjithësova atë kompani, do të jem me korrekt për hera tjera.

z. Adnan Reka: E pranoj kërkim faljen, unë e bëra një pyetje shumë legjitime për kryetarin: Cili është plani i juaj, çka keni plan me bërë me kompanitë që nuk i kanë përmbushur planet. Ne pa e ditur planin e kryetarit çka ka me bërë, nuk mundemi me dhënë rekomandim.

Kryetari i Komunës: Kryetari i trajton këto tema se e ka obligim ligjor me u marrë raportet e komisionit, i shqyrton hapat dhe mundësitë. Ligji e përcakton që ata që nuk i kanë përmbushur kontratën, shfuqizohet kontrata dhe vendimi i KK, prona i kthehet komunës. Gjendjen po e shohim, kryetari në bashkëpunim me ekzekutivin e shikon hapat që duhet marrë, se a mundet me vazhduar tutje apo me ndërprerë kontratën. Unë kështu mendoj, mund të jam gabim.

z. Adnan Reka: Faleminderit për sqarime, por unë kërkoj direkt nga kryetari si përgjegjës, me i dhënë këto sqarime për obligimet që i ka ndaj kontratave me kompanitë, se është palë kontraktuese. Ndoshta të njëjtat fjalë i thotë kryetari, por unë po kërkoj nga kryetari me ditur se cili është mendimi i tij, ideja, qëllimi, plani i tij ?

Kryetari i Komunës: Nuk kam përgjigje.

z. Selajdin Troni: Për këtë ofertues, nuk kemi çka me folur, shumicën e punëve i kryer në bazë të kontratës, ndërkaq mundet me pasur cikërrime të vogla që të gjithëve na ndodhë edhe në punët e përditshme që nuk arrijmë me i kryer me kohë, besoj se ato janë kaluese. Për gjëra të vogla, nuk bënë të bëhemi pengesë, ashtu që për këtë operatorë jam me ia zgjatur afatin edhe për 3-6 muaj.

z. Agim Çaka: Aty ku shihet që është punuar, e kam për obligim si anëtar i KK, me thënë fjalë të mira dhe që është bërë punë e mirë. Ku t ‘kishin qenë edhe dy operatorët paraprak si ky dhe diskutimi nuk ishte zgjatë shumë. Në bazë të asaj që kam pa dhe informatave që kam, personi ka punuar, investuar dhe është në rrugë të mirë deri tani. Për më tutje, besoj se keni me përcjellë punën e tij dhe keni me raportua.

z. Bashkim Krasniqi: Në raporte është paraqitur gjendja reale për secilin operator. Ne këtu duhet me marrë një vendim se çka me bërë tutje lidhur me kontratat e lidhura me operatorët. Unë mendoj se duhet me iu dhënë edhe një afat të gjitha operatorëve për me i kryer punët. Nëse pas afatit të përcaktuar nuk i kryejnë punët, atëherë duhet me marrë veprime tjera. Kështu në si KK sot duhet të dalim me një rekomandim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne nuk kemi të drejtë me marrë vendim, kryetari me stafin e vet i shqyrton këto çështje dhe vendosë, se nënshkruet i kontratës është kryetari. KK e ka dhënë

pronën dhe ia merr operatorit kur të jepet propozim vendimi nga kryetari i komunës për me ia marrë, me arsyetim se nuk është zbatuar kontrata deri në fund. Kryetari i mbetet obligim me vlerësuar akoma raportin e komisionit lidhur me vlerësimin e kontratave dhe me shikuar hapat që ka me i marrë. Ne jemi për me bërë zgjidhje për secilin operator, por kur një operator nuk ka bërë asgjë në atë pronë, ne nuk mund të shkojmë në pafundësi. Sido që e vlerëson ekzekutivi dhe e sjellë rekomandimin në KK, ne jemi me ia dhënë edhe mundësinë, po jo atyre që nuk e kanë ndërmend me punuar asgjë.

z. Agim Mani: Të përzërja e kompetencave, se këtu është formuar një komision vlerësues dhe ai komision i rekomandon kryetarit. Ne si KK i kemi kompetencat e ndara. Ne nuk mundem me dhënë afat shtesë, afat shtesë jep komisioni dhe ka dhënë, kjo i takon kryetarit dhe kryetari të veproj sipas ligjit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne nuk kemi rekomandim prej komisionit si me vepruar, atëherë kjo i bien ekzekutivit me marrë veprime të nevojshme lidhur me investimet që janë bërë apo nuk janë bërë dhe pasojat juridike bien mbi këtë organ. Ne si KK kurdo që na vjen raport nga kryetari apo komisioni jemi të gatshëm me shqyrtuar dhe vendosë për atë çështje. Pati fjalë të mira për këtë operator. Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-17754/2021 të datës 25.06.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për katër dhjetë (40) vjet me Vendim të KK, e cila pronë gjendet në Zonën Kadastrale në Begracë, me numrat e parcelave P-70917003-01579-2 në sipërfaqen e aprovuar 00.58.39ha dhe P-70917003-01580-2 në sipërfaqen e aprovuar 01.75.40ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër “JLG CONSTRUCTION” SH.P.K, me pronar Agron Zeneli Operator Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7155/23.

13.Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Dhënien në shfrytëzim të pronave komunale në afatgjatë, unë personalisht e konsideroj shumë të rëndësishme dhe vitale, zhvillimin e bizneseve, rritjen e punësimit dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Do të ishte shumë me interes që komuna t’iu ofroj këtyre parcelave infrastrukturë të kompletuar, që do të lehtësonte investimin për sipërmarrësit. Kërkoj sqarime nga kryetari, Kontrata e nënshkruar nga N.P “X- PLAST” si biznes individual, pastaj në raport shihet se ky biznes është shndërruar në biznes SH.P.K. A është përfshirë ky ndryshim në ndonjë aneks kontratë, se nga N.P është shndërruar në SH.P.K ? Duke iu referuar raportit të komisionit dhe fotove të realizuara, shihet se biznesi ka instaluar makineri për prodhimin e dyerve dhe dritareve plastike, e jo makina për qepjen e rrobave me çka ofertuesi ka lidhur kontratë me komunën. A bien ndeshë kjo me destinimin dhe kontratën e lidhur? Sipas raportit, numri i punëtorëve ishte minimal, numri parashihej në kontratë të jetë 35, shpresoj të arrihen këto objektiva nga ofertuesi, pasi punësimi dhe numri i të punësuarve është interes për komunën tonë. Pyetje: Parcela që i është dhënë ofertuesit, a mos është i paraparë si lokacion për varreza?

z. Qamil Stagova: Lokacioni që e aprovuat paraprakisht nuk është larg me këtë lokacion, përndryshe nuk është për varreza.

Kryesuesi i Kuvendit: Si biznes dhe si ofertues ka qenë bindës, ka pasur shumicën e punëtorëve të gjinisë femërore, që ne duhet me iu dhënë prioritet bizneseve që punësojnë gra, se niveli i punësimit të grave të ne është shumë i ultë, kështu mirë është me iu dhënë prioritet bizneseve që punësojnë gra. Shumicën e bizneseve që pronat ua kemi dhënë në shfrytëzim, kanë problem me punëtorë, se nuk aplikojnë, ndihet mungesë e fuqisë punëtore se një pjesë e madhe e punëtorëve kanë shkuar jashtë.

Kryetari i Komunës: Qëllimi ka qenë me iu mundësuar bizneseve rritjen e zhvillimit ekonomik, rritjen e numrit të punësuarve. Kjo na ka bërë që punësimi i numrit të gjinisë femërore të jetë 85% me 15. Ajo që kam arritur me kuptuar nga vizita e parë e komisionit, Biznesi i ka përmbushë 2 kritere në fazën e parë dhe të dytën. Në fazën e tretë ka përmbushur kriterin e 3, por ia ka ndërruar destinimin. Ne bashkëpunim me komisionin do të dalim me një rekomandim sesi të veprojmë me këtë biznes.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-38948/2019 të datës 09.12.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katër dhjetë (40) vjet me Vendim të KK, pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale Nr. P-70917021-00217-1 Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, sipërfaqja e aprovuar 00.66.09ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër N.P. “X-PLAST” me përfaqësuesin Nexhat Vogliqi Operator Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7151/23.

14.Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Naim Beça: Unë nuk e kam problemin me punë kryesin, por me komisionin. Kush e formon komisionin, kuji i jep raport ky komision ? Diçka nuk është në rregull këtu, investimet e ofruara nga ofertuesi me një fletë të thjeshtë, nuk e di a janë euro apo denarë, se këto janë shkruar me një fletë të thjeshtë shpenzimet që i ka bërë. Nuk ka kurrfarë baze juridike. Në konstatim të komisionit thuhet: Komisioni gjatë inspektimit në terren ka kërkuar dëshmi lidhur me investimin e bërë në parcelë dhe personi ka ofruar një shënim. E ka dorëzuar investitori me një fletë të bardhë, ndoshta nuk i ka pasur kushtet, por shumat janë marramendëse. 2. Sipas komisionit, investuesi ende nuk ka leje të ndërtimit, e ka ndërtuar objekti dhe ende nuk ka leje, ndërkaq komisioni ka konstatuar se ky investitor duhet me vazhduar, komisioni nuk e ka marrë përgjegjësinë, por e ka bartë të kryetari i komunës. Komisioni ka dhënë disa konstatime, një prej tyre është se ofertuesi iu ka përmbajtur planit ideor, në të gjitha pikat si në ofertë. Si mundet me iu përmbajtur kur nuk kanë leje. Komisioni gjatë inspektimit ka kërkuar dëshmi në lidhje me numrin e të punësuarve sipas kontratës. Edhe kjo nënkuptohet, por si komision nuk i përmbushur detyrat, se është dashur vlerësimi të jetë negativ se ofertuesi nuk i ka përmbushur çështjen e lejes së ndërtimit, investimet i ka pasqyruar me një fletë të thjeshtë, ndërkaq komisioni i ka pranuar si dëshmi.

z. Selajdin Troni: Komisioni ka dhënë konstatim se ofertuesi ka ofruar dokumentin e shpenzimeve, nuk i ka bërë komisioni këto, por komisioni ka raportuar për dokumentet e

ofruara. Tani mbetet në përgjegjësi të kryetarit se a i jepet afat 3 apo 6 muaj, për me i përmbushur kontratën ashtu siç e përcakton ligji.

z. Naim Beça: Unë nga përvoja e kam se kam qenë në komisione. Komisioni duhet me i kërkuar investimet. Investimet duhet të jenë me kompjuter, se kështu në këtë formë janë të pakuptueshme, se nuk dihen në çfarë vlerash monetare janë bërë, nëse në euro duhet diku me figuruar €, pastaj investim nuk janë shpenzimet e karburantit. Mendoj se komisioni ka bërë shumë gabime, për atë po themi se unë kam problem me komisionin.

Kryesuesi i Kuvendit: Naim, komisioni ka përgjegjësi nëse ka pranuar atë letër në atë formë, a e ka pranuar apo jo nuk e di. Nëse komisioni e ka pranuar atë vlerë të shpenzimeve, komisioni mban përgjegjësi, ndërkaq nuk e di a ka pasur mundësi me u skanuar e më u bërë me mirë.

z. Adnan Reka: A ka leje ndërtimore apo jo ky ofertues?

z. Qamil Stagova: Nuk e di a ka leje ndërtimore apo jo, tani sa iu shkrova zyrtarëve. Parimisht duhet me pasur leje ndërtimore.

z. Adnan Reka: Këtu thuhet nga sektori i drejtorisë së Urbanizmit, na kanë njoftuar se në këtë parcelë nuk ka leje ndërtimi. Ju jeni drejtor i departamentit, dhe nuk e dini a ka leje ndërtimore apo jo.

z. Qamil Stagova: Unë nuk thash se ka leje ndërtimore. Unë nuk kam qenë drejtor në atë kohë, edhe pasi kam ardhur, ka bërë ndërtim tjetër.

z. Agim Çaka: Për mua është e mjaftueshme që i pashë tre modele të këtyre ofertuesve se çka kanë mundur me bërë në bazë të konstatimeve të këtij komisioni. Modeli i parë është që nuk kanë punuar hiq. Modeli i dytë është që ka punuar, por jashtë procedurave. Modeli i tretë ishte me miri për realizimin e qëllimit të planeve dhe projekteve që i kanë. Kësaj të tretës me ia dhënë mundësinë se kanë treguar seriozitet e korrektësi ndaj komunës, vetvetes dhe qytetarëve. Pjesa që duhet me u marrë ju me tepër është e para dhe e dyta, nuk po ndalem individualisht për secilin rast në konstatime, por për çdo lëvdatë është kjo e treta.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr.104/02-39226/2019 të datës 12.12.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet me Vendim të KK pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale P-70917003-002706-6 në Zonën kadastrale Begracë, në sipërfaqen e aprovuar 00.20.01ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër Fatmir Gashi B.I me përfaqësuesin Fatmir Gashi Operator Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7154/23.

15. Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik “KAÇINKA” L.L.C;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Arta Avdiu: Me intereson cili është dëmi financiar që operatori ekonomik “KAÇINKA” L.L.C, i ka shkaktuar komunës? A i keni kërkuar ju si komunë ndonjë dëmshpërblim operatorit ekonomik për mos plotësimin të kushteve? Gjithashtu shqetësimi im të ky raport është, pse nuk i keni njoftuar vërejtjet që 6 muaj për ndryshimin e realizimit të kontratës?

Kryesuesi i Kuvendit: Prona është në Kaçanik të Vjetër. Në bazë të asaj që e shohim, operatori pos që ka rrafshuar një vend, nuk ka bërë asgjë tjetër. A i ka shkaktuar dëme komunës, nuk besoj, se ajo pjesë ka qenë djerrinë përpara me keq sesa tani. Ky operator ekonomik është duke punuar në Kaçanik të Vjetër, e ka një objekt me qira me duket dhe ka punëtorë bukur shumë. Nuk e di arsyet pse nuk ka investuar në pronën që iu ka dhënë në shfrytëzim, por ka investuar në pronën me qira.

z. Adnan Reka: E kuptoj atë që ju po doni me i mbuluar përgjegjësitë penale se ju nuk keni përgjegjësi penale, as unë as ti. Lë të japin para kamerës ata që kanë përgjegjësi penale.

z. Qamil Stagova: E Njoftoj KK se operatori ekonomik nuk ka leje ndërtimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka. Lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-8678/2021 të datës 22.03.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katër dhjetë (40) vjet me Vendim të KK, pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale P-709170086-00402-0 Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, sipërfaqja e aprovuar 00.95.48ha dhe Parcelën kadastrale P-70917085-00403-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër “KAÇINKA” L.L.C me pronarin Jetmir Shehu Operator Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7148/23.

16.Raport i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues të ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: Kritikat janë për mos raportim në çdo 6 muaj, por kryetari u arsyetua me pandeminë. Edhe ky raport që na është ofruar, nuk është rezultat i monitorimit dhe nuk përputhet me realitetin. Të raporti N.SH.T ”LYPETENI”, konstatimi i komisionit është se ofertuesi i është përmbajtur planit të biznesit në të gjitha pikat e përshkruara si në plan të biznesit dhe ka filluar të bëjë prodhimin e veprimtarisë. Këtë konstatim mundet me besuar secili, mirëpo kryetar e keni shtëpinë veç 100 metra nga aty dhe mundeni me vërejtur se aty nuk është filluar me prodhuar, aq me pak me eksportuar jashtë. A mundesh me kundërshtuar këtë? Sa i përket numrit të punësuarve, menaxheri deklaroi se është hapur konkursi për rekrutim, por nuk ka pasur të interesuar. Kur do të fillon konkursi i ri për praninë? Qysh mundet me ia nisur prodhimin, kur nuk ka punëtorë?

Kryesuesi i Kuvendit: Ka të punësuar 10 punëtorë.

znj. Ernesta Krasniqi: Në vitin e tretë thuhet se operatori ekonomik ka me i pasur 64 punëtorë, ndërkaq nuk i ka këtë numër të punëtorëve. Qysh mundet me ia nisur me prodhuar me 10 punëtorë, se për 10 punëtorë nuk investohet mbi 1 milion euro, kjo nuk është në përputhje me planin e zhvillimit?

z. Brahim Imishti: Ata punëtorë aty janë duke bërë një punë të përkryer të dizajnit, mobilierive të ndryshme, nuk e di a i keni pa apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse duhet me u vlerësuar dikush, është ky investitor, se është i vetmi që i ka dëshmuar me dëshmi komisionit për ato që i ka realizuar. Ka dëshmuar se ka me krijuar prodhimtari të mobileve, është duke prodhuar, është duke plasuar tregun e jashtëm ashtu siç ka

thënë, e ka dëshmuar edhe me kontrata. Të numri i punëtorëve, nuk e ka përmbushur dhe një kriter që nuk e ka përmbushur është një furrë të druve me tërë drurin, por është i vetmi operator që është përballë edhe me probleme pronësore me ata fqinjët aty, të cilat këto nuk figurojnë në raport. Për kundër këtyre, është angazhuar me përmbushur planin që e ka pasur, e ka përmbushur planin dinamik, vlerën e investimit, ndërkaq ka ngecë numri i punëtorëve që mund të jetë problem me përmbushur edhe për një kohë të gjatë, se të gjitha kompanitë janë duke pasur problem me numrin e punëtorëve Në bazë të informatat që kam nga bizneset tjera të prodhimit të drurit, janë duke e zëvendësuar me makineri robotike, se janë duke pasur problem me gjetur punëtorë fizik.

znj. Ernesta Krasniqi: Prodhimin a është duke e realizuar në Kaçanik të Vjetër apo prej selisë që e ka pasur me herët, se prodhimtarinë e ka të njëjtë ? A mendoni ai biznes duhet me u zhvilluar pikërisht në atë vend, se banorët janë duke i nxjerrë shtëpitë në shitje?

Kryesuesi i Kuvendit: Prodhimtarinë është duke e bërë aty, të pjesa tjetër ka prodhimtari tjetër, ndërkaq as një ndotje nuk ka aty.

z. Selajdin Troni: Unë e kam përcjellë këtë lëndë, është një prej lëndëve me të mira. Pjesën e prodhimit të drurit e ka me vite që zhvillon këtë veprimtari. Pengesa normale se mundet me pas. Të pjesa e punëtorëve, kjo është problem me të gjithë, është një prej ofertuesve me të mirë që e ka dëshmuar pikë për pikë përmbushjen e kontratës.

z. Adnan Reka: Ne nuk jemi kundër investitorëve serioz, se pyeti Rustemi, por jemi kundër shkeljeve ligjore dhe manipulimeve me ofertues joserioz. Ne nuk na intereson kush është ofertues, vetëm na intereson serioziteti i tij dhe interesi i vendit. Prej bizneseve që kanë marrë pronë, sa objekte janë në total pa leje dhe sa janë me leje? Drejtori ose kryetari e ka obligim me na u përgjigjur.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë në raport dhe mundemi me i mbledhur edhe vet.

z. Adnan Reka: Drejtori ose kryetari e ka obligim me u përgjigjur para kamerave për qytetarë, jo për mua. A keni përgjigje apo jo?

Kryetari i Komunës: Në raport janë Adnan, mundemi me i numëruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, lidhur me Kontratën 01Nr. 104/02-39228/2019 të datës 12.12.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet me Vendim të KK, pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale P-70917086-01405-0 në Zonën kadastrale Kaçanik i Vjetër, sipërfaqja e aprovuar 00.86.24ha, e lidhur në mes Komunës së Kaçanikut me përfaqësuesin Besim Ilazi Autoritet Kontraktues dhe në anën tjetër N.SH.T “LYPETENI” me përfaqësuesin Fadil Guri Operator Ekonomik, Kuvendi i Komunës

K O N K L U D O J

Që Kryetari i Komunës në bazë konstatimeve dhe rekomandimeve të komisionit për përmbushjen e kontratës sipas Planin dinamik investim, Planin e biznesit, Investimet, Numrin e të punësuar, Lejen ndërtimore, Projektin ideor, të merr veprime të mëtutjeshme në pajtim me dispozitat e nenit 22 si dhe nenit 23 të Ligjit 06L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenit 27 dhe 28 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-7147/23.

17. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: A ka mundësi me na treguar pse nuk po ndërtohet, por po destinohet mjetet diku tjetër?

Kryetari i Komunës: Meqë është hera e tretë që Zyra e prokurimit ka shpallur tender, është fjala për ndërtimin e urës të ETC, na ka dështuar projekti, hera e tretë e nënshkrimit të kontratës. Nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër, është dita e fundit e ankesës dhe duke e pa kohën. Janë 85,000 €, nga të HVK dhe GQ, ndërkaq duke ditur se kemi shpenzime për rrugë lokale, urbane e rurale, është llogaritur me i destinuar këto mjete, që nëse kompania punon, ka kohë të mjaftueshme me i shpenzuar shumën 40,000€. Kjo është arsyeja që mos me i rrezikuar mjetet.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk është problemi pse po destinohen, por pse ka dështuar projekti? Për hera tjera, të jetë si sugjerim, kur të destinohen mjete, të jetë një arsyetim pse po ndodhë kjo.

Kryetari i Komunës: Është hera e tretë, dy herë nuk kemi pasur ofertues, edhe pse është rritur vlera e urës nuk kemi pas ofertues.

z. Agim Mani: Për këtë çështje kemi folur edhe me herët të raporti financiar. Të ky rialokim i mjeteve, të planifikimi urban dhe inspekcioni, këto mjete rialokohen nga projekti Ndërtimit të urave, në projektin, Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale. E potencova edhe me herët që projekti, rregullimi dhe ndërtimi i rrugëve rurale, e ka tejkaluar shumën për 9,000€. Qysh mendoni ju edhe 45,000€ me i rialokuar në këtë projekt ?

Kryetari i Komunës: Nuk e tejkalon Agim, mos e merrni kaq lehtë këtë punë, se edhe neve na monitoron dikush, se të pjesa e grantit nga shuma 190,000€ ka qenë një pjesë e obligimeve të vitit të kaluar që iu kanë kompensuar sivjet kompanive. Pastaj 50,000€ nëse nuk gabo, sipas zyrtarëve që kemi obligim ndaj kompanive me të njëjtën kontratë. Drejtori i dinë me mirë shifrat, por mos mendoni që mundemi me bërë një shkelje të tillë qysh po mendoni ju, nuk guxon as drejtori as kush tjetër. Ne i kemi paraparë ku shkojnë ato mjete, prandaj jemi duke bërë ridestinimin e tyre, se ne monitorohemi për këto mjete nga MFET i dërgojmë edhe shkresë, njoftim edhe dëshmi për këto mjete.

z. Agim Mani: Në vitin e kaluar, kanë përfunduar projekti i rregullimit dhe ndërtimit të rrugëve rurale. Tenderi i ri është hapë në qershor dhe ajo e ka mbuluar koston e vet, bile edhe e ka tejkaluar. Tani këtë shumë qysh doni me ridestinu, kjo mbetet në përgjegjësi të juaja.


Kryetari i Komunës: Me duket se isha shumë i qartë Agim, me shumën e mjeteve kontrata që ka qenë një vjeçare që ka qenë në qershor. Ajo ka punuar edhe këtë vit, dhe nga shuma 190,000€ iu ka paguar kompanisë që e ka pasur me kontratë, pjesa e kontratës tjetër kjo e reja është 190,000€, gjë që mjetet nuk kanë qenë sa ka qenë kontrata, kështu që kemi hapësirë me bërë pagesën e tyre. Për atë thash se nuk guxon as drejtori e askush tjetër me bërë shkelje të tillë. I kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë me i shfrytëzuar mjetet e GQ, andaj e kemi bërë propozim vendimin.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër 7 nga LVV, Abstenoj 1 -Agim Çaka. Prezent 24. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për rialokimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në nën-programin Planifikim urban dhe inspeksioni, sipas buxhetit të vitit 2023/ Lënda: 01Nr. 400/03-27749/23.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 16:22. Deri në fund të mbledhjes ishin 24 anëtarë, pasi anëtarët Besnik Salihu, Raif Kasa, Hamide Luma, kanë dalë me herët nga mbledhja (sipas renditjes; i pari gjatë pikës 2, i dyti nuk ishte në pjesën e dytë të mbledhjes, i treti gjatë pikës 10).



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Data	30.10.23	Vendi	Kaçanik
Org.		Numri	
	01		104/02-2022

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 16.10.2023 Nr: VI-020-780
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtarë e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik

E miratuar më datë: 27.09.2023

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2023

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2023, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është në *kundërshtim* me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, *paragrafin 5 të nenit 29 ku përcaktohet se "Prona që kërkohet të këmbëhet, paraprakisht duhet të jetë shpallur nga kuvendi i komunës pronë me interes publik, përveç nëse nevoja për pronën e tillë arsyetohet në planet zhvillimore të komunës"*.

Vendimi 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik, duhet të rishqyrtohet sepse njëherë duhet të miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik e pastaj të miratohet vendim për këmbim të pronës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



01Nr. 104/02-24408/23
Kaçanik, 27.09.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokal (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092 -për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 6 (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet DUKMM 01Nr.104/02-24408/23 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 shtator 2023, mori këtë:


VENDIM


**PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PJESËN E PARCELËS
KADASTRALE 00153-24 ZONA KADASTRALE KAÇANIK NË EMËR TË RAMIZ
SHAQIRI PËR KËMBIM ME PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 01908-15 PRONË
SHOQËRORE KOMUNA KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim, SHPALLET me interes të përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale 00153-24, e cila gjendet në Zonën kadastrale Kaçanik, në sipërfaqe 27.47m².
2. Këmbimi i paraparë me këtë Vendim nënkupton:
 - 2.1 Pjesa e parcelës kadastrale 00153-24, me sipërfaqe 27.47m², me pronar Ramiz Shaqiri nga Kaçaniku, këmbëhet me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15, me sipërfaqe 42.41m², e cila në shënimet e Zyrës Kadastrale të Kaçanikut shënohet si Pronë Shoqërore, Komuna Kaçanik. Pronat e lartpërmendura gjenden në Zonën Kadastrale Kaçanik.
3. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës kadastrale nga pika 1. e këtij vendimi, është për zgjerimin e rrugës "Emsale Frangu" përmes së cilës kalojnë nxënësit e SHFMU "Emin Duraku", banorët e asaj pjese dhe qytetarët tjerë të cilët e shfrytëzojnë atë rrugë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës: Propozim Vendimi i Kryetarit, arsyetuar nga DUKMM, Certifikatat e pronësisë, Manuali i studiuar nga gjeodeti i licencuar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Data	30.10.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	01	104/02-	25724

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Data: 16.10.2023 Nr: VI-020-780
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 01 Nr. 60/01-24386/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 zona kadastrale Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore Komuna Kaçanik
E miratuar më datë: 27.09.2023
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2023

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2023, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 60/01-24386/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 zona kadastrale Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore Komuna Kaçanik.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është në *kundërshtim* me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, *paragrafin 5 të nenit 29 ku përcaktohet se "Prona që kërkohet të këmbëhet, paraprakisht duhet të jetë shpallur nga kuvendi i komunës pronë me interes publik, përveç nëse nevoja për pronën e tillë arsyetohet në planet zhvillimore të komunës"*.

Vendimi 01 Nr. 60/01-24386/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 zona kadastrale Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore Komuna Kaçanik, duhet të rishqyrtohet sepse njëherë duhet të miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik e pastaj të miratohet vendim për këmbim të pronës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



01Nr. 60/01-24386//23
Kačanik, 27.09.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokal (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 6 (h) e Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet DUKMM 01Nr. 60/01-24386/23 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 shtator 2023, mori këtë:


VENDIM


PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00643-0 ZONA KADASTRALE KAÇANIK NË EMËR TË ADNAN VISHI PËR KËMBIM ME PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00644-1 PRONË SHOQËRORE KOMUNA KAÇANIK

1. Me këtë vendim, SHPALLET me interes të përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale 00643-0, në Zonën kadastrale Kačanik, në sipërfaqe 56m².
2. Këmbimi i paraparë me këtë vendim nënkupton:
2.1 Pjesa e parcelës kadastrale 00643-0, me sipërfaqe 56m², me pronar Adnan Vishi nga Kaçaniku, këmbëhet me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1, me sipërfaqe 59m², e cila në shënimet e Zyrës Kadastrale të Kaçanikut shënohet si Pronë Shoqërore, Komuna Kačanik.
3. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës kadastrale nga pika 1. e këtij vendimi është, krijimi i mundësitë së rregullimit të hapësirës pranë Sheshit të qytetit, i cili është në ndërtim e sipër (prona e ish Çerdhes së fëmijëve) dhe pranë rrugës "Sali Bajra".
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës: Propozim Vendimi i Kryetarit, arsyetuar nga DUKMM; Certifikatat e pronësisë; Manuali i studiuar nga gjeodeti i licencuar, Marrëveshja 06Nr.941/01-24811/23 e datës 04.09.2023.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursefi





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	30.10.23	Vendi	KAÇANIK
lj. org.		Numri	01
		Shtojcë	105/02-28125

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Data: 16.10.2023 Nr: VI-020-780
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 01 Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 zona kadastrale Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar Komuna Kaçanik
E miratuar më datë: 27.09.2023
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2023

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2023, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 zona kadastrale Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar Komuna Kaçanik.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është në *kundërshtim* me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, *paragrafin 5 të nenit 29 ku përcaktohet se "Prona që kërkohet të këmbëhet, paraprakisht duhet të jetë shpallur nga kuvendi i komunës pronë me interes publik, përveç nëse nevoja për pronën e tillë arsyetohet në planin zhvillimor të komunës"*.

Vendimi 01 Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 zona kadastrale Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar Komuna Kaçanik, duhet të rishqyrtohet sepse njëherë duhet të miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik e pastaj të miratohet vendim për këmbim të pronës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



01Nr. 60/01-24387/23
Kačanik, 27.09.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092 -për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 6 (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet DUKMM, 01Nr. 60/01-24387/23 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 shtator 2023, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00544-0 ZONA KADASTRALE KOXHAJ NË EMËR TË MEJDI XHOKLI PËR KËMBIM ME PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00545-0 PRONË SHOQËRORE RRUGË E PAKATEGORIZUAR KOMUNA KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, SHPALLET me interes të përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale 00544-0, e cila gjendet në Zonën kadastrale Koxhaj, me sipërfaqe 41.72m².
2. Këmbimi i paraparë me këtë vendim nënkupton:
 - 2.1 Pjesa e parcelës kadastrale 00544-0, me sipërfaqe 41.72m², pronë e Mejdi Xhokli, këmbëhet me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0, me sipërfaqe 41.72m², e cila në shënimet e Zyrës Kadastrale të Kaçanikut shënohet si Pronë Shoqërore, Rrugë e pakategorizuar, Komuna Kačanik. Pronat e lartpërmendura gjenden në Zonën Kadastrale Koxhaj.
3. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës kadastrale nga pika 1. e këtij vendimi, është për zgjerimin e rrugës "Ramadan Xhokli".
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës: Propozim Vendimi i Kryetarit të komunës, Certifikatat e pronësisë; Manuali i studiuar nga gjeodeti i licencuar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik - Municipality Kaçanik



01.Nr.

Datë

■ pjesët e parc.kad.nr.1217-1,1217-2,1217-3,1217-4,1217-5 me sipërfaqe të përgjithëshme prej: $S=307m^2$ me pronar z.XHafer Maksut Elezi nga fsh.Sllatinë e që kjo sipërfaqe është edhe propozim për këmbim me pjesën e parc.nr.738-2 me pronar Komuna Kaçanik me sipërfaqe prej $S=1136m^2$

— kufiri faktik që tregon se deri aty është dëmtuar prona private

XHafer Elezi për parc.nr.1217-1,1217-2,1217-3,1217-4,1217-5

Komuna e Kaçanikut parc.nr.738-2

nënshkrimi

nënshkrimi






PLANI I PARCELËS 737-0 E QË ËSHTË PROPOZIM PËR KËMBIM ME PRONËN KOMUNALE NR.738-2



z.kad.Sllatinë

parc.kad.nr.737-0 me pronar:XHafer Maksut Elezi nga fsh.Sllatinë

parc.kad.nr.738-2 me pronar:Komuna Kaçanik



shpjeguesi:

— kufit kadastral të parcelave

■ pjesa e parc.kad.nr.737-0 me sipërfaqe prej: $S=61m^2$ me pronar z.XHafer Maksut Elezi nga fsh.Sllatinë e që kjo sipërfaqe është edhe propozim për këmbim me pjesen e parc.nr.738-2 me pronar Komuna Kaçanik me sipërfaqe prej $S=1136m^2$

— kufiri faktik që tregon se deri aty është dëmtuar prona private

XHafer Elezi për parc.nr.737-0

Komuna e Kaçanikut parc.nr.738-2

nënshkrimi

nënshkrimi

Qershor, 2023





Vërejtje :

■ Pjesë e parcelës 327-0

459 m² - Sipërfaqja qe pala kerkon per shendrim ne rrugë publike

1009 m² - Sipërfaqja qe ngelet ne pronesi te komunes

Parcela 704-2 qe pala kerkon ne teresi te kaloj ne pronesi te komunes





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



01 Nr. 104/02-30043/23
Datë 16.11.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 58 , pika (h) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/ 15 Qershor 2008*), të nenit 6, pika (b) dhe (h), të Statutit të Komunës së Kaçanikut, në zbatim të nenit 21, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.10 /03 Prill 2019*), nenit 24, paragrafi 1 dhe paragrafi 5, nenit 25, paragrafi 3 dhe paragrafi 6 të Rregullores QRK nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të Zgjerimit dhe përforcimit të rrjetit elektrik dhe furnizimin me energji elektrike për regionin e Komunës së Kaçanikut , Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm , Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës , në mbledhjen e radhës të merre këtë

PROPOZIM VENDIM

**Për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim në kohë të caktuar për raste të veçanta
Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS)**

1. Kuvendit të komunës për miratimin e vendimit për dhënien e pronës të paluajtshme të komunës në shfrytëzim për raste të veçanta Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me numër të biznesit 810799364, me seli në Prishtinë, adresa “Bulevardi Bill Klinton” nr.5
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, prona e paluajtshme e komunës e cila do të ipet në shfrytëzim janë:
 - 2.1. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917074-00653-0, Zona Kadastrale Rekë, pronë shoqërore pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, me sipërfaqja të përgjithshme 2451 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².
 - 2.2. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917086-02150-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër , pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, me sipërfaqja të përgjithshme 17494 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².
 - 2.3. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917086-01406-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër , pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, me sipërfaqja të përgjithshme 5378 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².
 - 2.4. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917086-02144-2, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër , pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, me sipërfaqja të përgjithshme 45227 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².

2.5. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917086-00966-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër , pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, ,me sipërfaqja të përgjithshme 2550 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².

2.6. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917041-00423-0, Zona Kadastrale Ivajë, pronë shoqërore me pronar Komuna e Kaçanikut, ,me sipërfaqja të përgjithshme 7500 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 30 m².

2.7. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917041-01062-0, Zona Kadastrale Ivajë, pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, ,me sipërfaqja të përgjithshme 24041 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m².

2.8. Pjesë e njësisë kadastrale P-70917041-01392-0, Zona Kadastrale Soponicë, pronë shoqërore me pronar P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuara, ,me sipërfaqja të përgjithshme 66203 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 62 m².

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën 2 të këtij Vendimi është vendosja e trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Rekë,(projekti Malësi), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër (projekti Qardak 3) , trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 100kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Qardak 3), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Kotlinët), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 160kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Kotlinët) dhe vendosja e stabilimentit shpërndarës të tipit A me dimensione 5200x2200x2600 mm, zhvendosja e trafostacionit ekzistues TS Ivaj e Re, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 160kVA, në Fsh. Ivajë (projekti Bobi), vendosja e Transformatori 35/10(20)kVA 8MVA, me bazament (3*3.5)m dhe vendosja e Transformatori 10/(20)0.4kV, me Fuqi 50kVA shtëpizë Metalike të Tipit B, në Fsh. Soponicë ,(projekti Kaçaniku II), të gjitha këto investime bëhen sipas planit investiv 2022-2023 për zgjerimin dhe përforcimin të rrjetit shpërndarës të Energjisë Eletrike për regjionin e Komunës së Kaçanikut.

4. Afati për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes të përshkruar në pikën 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7,2.8 është periudha prej **40 viteve**.

5. Kompensimi i sipërfaqes tokësore e cila është objekt i këtij vendimi në emër të qirasë mujore për shfrytëzim është:

Zona Kadastrale Rekë **0,20 €/m² (9 m² x 0.20 € = 1.8 €)**

Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër **0,20 €/m² (36 m² x 0.20 € = 7.2 €),**

Zona Kadastrale Ivajë **0,20 €/m² (39 m² x 0.20 € = 7.8 €) dhe**

Zona Kadastrale Soponicë **0,20 €/m² (62 m² x 0.20 € = 12.4 €)**

(llogaritja e Qirasë bëhet sipas Rregullores nr. 02/2020 për Taksat Komunale , neni 16 pika 3)

6. Pronat e përcaktuara në njësitet kadastrale të pikave; **2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8,** të këtij Vendimi, janë prona të Komunës së Kaçanikut dhe Pronat e propozuara për dhënien në shfrytëzim nuk kanë kontest pronësor me asnjë palë, janë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor, shfrytëzimi i tyre bazohet në ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale

7. Procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe me Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave

të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës do t'i zhvillohen sipas Dhënies në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, dhe për të cilën Procedurat e konkurrimit nuk zbatohen për dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë së ripërtitshme.

8. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.

9. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.

Arsyetim

Pas kërkesës se ushtruar nga Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), për shfrytëzimin e pronës komunale për projektin e planit investiv 2022-2023 për regjionin e Komunës së Kaçanikut lidhur me Investimet, vendosja e trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Rekë, (projekti Malësi), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër (projekti Qardak 3), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 100kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Qardak 3), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 250kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Kotlinët), trafostacionit të ri, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 160kVA, në Fsh. Kaçanik i Vjetër, (projekti Kotlinët) dhe vendosja e trafostacionit ekzistues TS Ivaj e Re, tipi shtyll betoni 10(20)/0.4 kV me fuqi 160kVA, në Fsh. Ivajë (projekti Bobi), vendosja e Transformatori 35/10(20)kVA 8MVA, me bazament (3*3.5)m dhe vendosja e Transformatori 10/(20)0.4kV, me Fuqi 50kVA shtëpizë Metalike të Tipit B, në Fsh. Soponicë, (projekti Kaçaniku II) të gjitha këto investime bëhen sipas planit investiv 2022 -2023 për zgjerimin dhe përforcimin të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike për regjionin e Komunës së Kaçanikut.

Kërkesës se ushtruar nga Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), për shfrytëzimin e pronës komunale për projektin e planit investiv 2022 me numër të protokollit 01/Nr.104/02-8220/2023, të datës 06.04.2023, si dhe Kërkesës se ushtruar nga Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), për shfrytëzimin e pronës komunale për projektin e planit investiv 2023 me numër të protokollit 01/Nr.104/02-26930/2023, të datës 13.10.2023 Komuna e Kaçanikut gjegjësisht Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka Shqyrtuar kërkesat dhe ka vendosur që lokacioni për ndërtimin për zgjerimin dhe përforcimin të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike për regjionin e Komunës së Kaçanikut, të vendos si në dispozitiv të këtij Propozim Vendimi.

Të bashkangjitur këtij Propozim Vendimi janë:

- Kërkesës se ushtruar nga Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), me numër të protokollit 01/Nr.104/02-8220/2023, të datës 06.04.2023
- Kërkesës se ushtruar nga Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), me numër të protokollit 01/Nr.104/02-26930/2023, të datës 13.10.2023
- Skica Grafike
- Kopja e Planit de Certifikata e pronës

Drejtori I DUKMM-së
z. Qamil Stagova





Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



	NJËSIA INVESTIMET	Nr.	KEDS-DIV-F-DIV-02
		Faqe	Faqe 1 prej 1
	KËRKESË PËR SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE	Versioni	1.0

Datë:	12.10.2023	9441	12 OCT 2023
Për:	Kryetarin e Komunës së Kaçanik z. Besim Ilazi		
Nga:	Alpin Dogan, Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS Turan Kocabayraktar, Drejtori i Departamentit për Investime Burbuqe Baruti, Inxhinierë për Bashkëpunim me Institucione Qeveritare		
Tema:	KËRKESË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SHOQËRORE/KOMUNALE SIPAS LIGJIT Nr.06/L-0921 DHE LIGJIT PËR ENERGJI Nr.05/L-081		
Lënda:	Projekti me Plan Investiv 2023 për regjionin e Komunës së Kaçanikut		

Në bazë të Planit Investiv 2023 për Zgjerim dhe Përforsim të Rrjetit Shpërndarës, KEDS ka paraparë të ndërtohet trafostacioni Kaçaniku II 35/10(20)kV 8MVA dhe trafostacioni shtëpizë metalike 10(20)/0.4kV me fuqi 50kVA për regjionin e Komunës së Kaçanikut me qëllim të përmirësimit të qëndrueshmërisë në furnizim, zvogëlimin apo eliminimin të reduktimeve për shkak të ngarkesës andaj kërkojmë nga titulli i lartshënuar që të jep lejen e shfrytëzimit të pronës shoqërore/komunale për projektin:

1. Projekti "Kaçaniku II"

- Vendosja e një transformatori 35/10(20)kV 8MVA me bazament (3x3.5)m në hapësirën prej 28[m²] dhe një trafostacion 10(20)/0.4kV me fuqi 50kVA shtëpizë metalike të tipit B me dimensione (6.1x2.2x2.6)m në hapësirën prej 34[m²] - në kuadër të parcelës nr.01392-0 ZK Soponicë (pronë shoqërore-rrugë).

Bashkangjitur gjeni fletën poseduese dhe kopjen e planit për parcelën e lartpërmendur.
Nr. kontaktues : 049/790-341 (burbuqe.baruti@keds-energy.com)

 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT QËSTINA KAÇANIK		
Data	13.10.27	Vendi
Kry. Org.	Numri	Shtojcë
09	104/02-26930	✓



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Direkcija za Opštu Upravu/Department of General Administration



16.11.2023



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK



I	Data	16.11.2023	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
			02-060/01-30017/23	

R A P O R T
I PËRMBUSHJES SË PLANIT TË INTEGRITETIT TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2022

NËNTOR 2023

Përmbajtja	3
HYRJE	4
Auditimi i brendshëm	4
Prokurimi publik	5
Administrata Komunale	6
Konflikti i interesit	6
Mospërputhja e funksioneve	7
Deklarimi i pasurive	7
Kabineti i Kryetarit	8
Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve	8
Inspektimi	9
Urbanizmi dhe Planifikimi	10
PËRMBLEDHJE	

HYRJE

Në çdo organizatë buxhetore e gjithashtu edhe në Komunën e Kaçanikut, Plan i Integritetit është një mjet për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit dhe rreziqeve të tjera të cilat dëmtojnë imazhin dhe integritetin e organizatës.

Çdo aktivitet i përditshëm i institucionit komunal përfshin rreziqe të caktuara dhe pavarësisht se çfarë bëjmë ne, kur përqendrohemi në detyrat tona të punës, ne mund të ekspozohemi me ose pa vetëdije me rreziqet të cilat janë paraparë se mund të ndodhin. Prandaj, pikërisht hartimi i Planit Komunal për Integritetin 2022-2026, është një mundësi për t'iu kushtuar më shumë kohë rreziqeve, ndërsa dokumenti i miratuar mundëson një pasqyrë të përhershme të rreziqeve me të cilat ne i kemi paraparë gjatë hartimit.

Sistemi bashkëkohor i qeverisjes së mirë kërkon që lider shipi dhe personeli t'i identifikojnë ato rreziqe; të hartojë masa për eliminimin e rreziqeve ose zvogëlimin e mundësisë së shfaqjes së tyre, për t'i analizuar këto masa në mënyrë të vazhdueshme dhe për të raportuar për to.

Prandaj, në Planin Komunal për Integritet 2022-2026, fushat e rreziqeve janë ndarë në dy pjesë:

1. **Në fushat specifike të rrezikut** (Prokurimi publik; Administrata Komunale; Konflikti i interesit; Mospërputhja e funksioneve; Deklarimi i pasurive; Kabineti i Kryetarit; Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve; Inspektimi; Urbanizmi dhe planifikimi; Edukimi dhe kultura; Shëndetësia dhe mirëqenia sociale dhe Bujqësia dhe zhvillimi rural) dhe

2. **Në fushat e përgjithshme të rrezikut**

Raporti në vazhdim do t'i shtjellojë çështjet më të rëndësishme (kryesore) të rreziqeve specifike të implementimit të Planit Komunal për Integritet 2022-2026 për gjashtë mujorin e mbetur të vitit 2022.

Auditimi i brendshëm

Zyra për Auditim të Brendshëm apo Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) është përgjegjëse veçanërisht për menaxhimi dhe mbikëqyrja e personelit dhe veprimtarive të NJAB-së; Siguron shfrytëzimin produktiv, ekonomik dhe efikas të burimeve të NJAB-së; Siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve; Siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planëve të caktuara; Organizon, kryen dhe mbikëqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm të ndërmarr nga NJAB, si dhe dorëzimin e rezultateve të auditimit para Komisionit të auditimit të organizatave buxhetore, apo ndërmarrjes autonome publike; Përgatitë dhe dorëzon raporte gjashtë mujore dhe vjetore mbi të gjitha aktivitete e auditimit të NJAB-së te Komisioni i auditimit i organizatës buxhetore apo ndërmarrjes autonome publike; Kryen auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga Ministria; Merr dhe shqyrton pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe informatat e dokumentit në posedim ose kontroll të subjektit të sektorit publik nën auditim; Kopjon të dhënat, informatat apo dokumentet e tilla për qëllime të auditimit të brendshëm dhe siguron që kopjet në fjalë të jenë origjinale ose të vërtetuara; Kërkon nga cilido zyrtar punonjës, këshilltar ose kontraktues i subjektit të sektorit publik nën auditim, që të ofrojë dëshmi fizike, shënime ose dëshmi gojore, ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin, ose mbi aktivitete që janë në auditim; Ka qasje pa pengesë në stabilimentet e subjektit të sektorit publik nën auditim, dhe verifikon dhe vlerëson vlerat material dhe monetare të subjektit të sektorit publik, në pajtim me rregullat dhe legjislacionin; Propozon masat që duhet të ndërmerren nga subjekti përkatës etj.

Mbi këto përgjegjësi dhe detyra, Auditimi i brendshëm sipas planit janë përshkruar rreziqet kryesore si: Kapacitete të pamjaftueshme të njësisë së auditimit të brendshëm, Praktikant e menaxhimit të auditimit të brendshëm janë të dobëta dhe Pavarësia e pamjaftueshme e njësisë së auditimit të brendshëm. Prandaj, në këtë drejtim gjatë hartimit të raportit gjashtë mujor në NJAB nuk janë hasur shkelje të cilat vijnë sipas veprimtarisë të kësaj zyre.

Prokurimi publik

Zyra e Prokurimit është përgjegjëse për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi si në vijim: Të zbatoj ligjin dhe legjislacionin dytësor të Prokurimit Publik; Të sigurojë që prokurimet publike të zhvillohen në mënyrën efikase, efektive, transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike; Të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e personave që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit publik; Të promovojë trajtim të barabartë dhe një treg të hapur të prokurimit dhe krijimin e një kulture institucionale për organet publike të bazuara në profesionalizëm dhe të pandikuara nga interesat personale; Të zbatojë rregullat e prokurimit publik të cilat tashmë janë të bazuara mbi parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë jo-diskriminues;

Zhvillimin e transparencës si instrumentin më të rëndësishëm të kontrollit që duhet përdorur në mënyrë që puna e institucioneve të përcillet nga jashtë; Mban evidencë për tërë procesin e prokurimit, prej fillimit deri në dhënien e kontratës;

Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat lidhur me një aktivitet të prokurimit, përveç informatave sekrete afariste; Me kërkesën e cilitdo person, t'i siguron qasje të të arsyeshme personit të tillë të interesuar që të ketë qasje në të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit bazuar në ligjet në fuqi për qasje në dokumentet publike pas përfundimit të një aktiviteti të prokurimit, me përjashtim të informatave sekrete afariste të kërkuara nga vetë operatori ekonomik;

Kujdeset që gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit të inkurajojë konkurrencën dhe të respektojë barazinë e pjesëmarrësve në procesin e prokurimit publik; Të realizon kërkesat e drejtorive në pajtim me planifikimin e prokurimit; Në konsultim me të gjitha Departamentet përgatit planin vjetor të prokurimit për Komunën e Kaçanikut; Raporton te Kryetari i Komunës në mënyrë periodike për punën e zyrës; Përgatit një Raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara. Ndihmon dhe sipas nevojës përgatit harmonizimin e Rregulloreve komunale që ndërliken me Ligjin e Prokurimit Publik; Pranimi dhe realizimi i kërkesave nga drejtoritë; Përcaktimi i procedurës; Përgatitjen e dokumenteve parakualifikuese, Dosjen e tenderit, kushtet e kontratës, raportet e vlerësimit të tenderëve, dhënien e kontratës dhe njoftimeve për publikim në KRPP. Komunikimi dhe shkrim me palët;

Organizimi dhe menaxhon takime para-ofertuese, hapjet e tenderëve dhe procesin e vlerësimit, si dhe përgatitja e raporteve. Kompletimi i lëndëve të prokurimit për të cilat është kryer vlerësimi; Përgatitja e kontratave në pajtim me ofertën e shpërblyer; Koordinimi i menaxhimit të kontratave me Komisionet mbikëqyrëse; Përgatitja e raporteve të prokurimit për KRPP dhe për Menaxhment; Pranimi i kërkesave të palëve dhe përgjigja në to brenda afateve të parapara me ligj; Pranimi i faturave, raporteve të mbikëqyrjes, raporteve të pranimit punëve, mallrave dhe shërbimeve dhe procedimi për pagesë.

Sipas këtij përshkrimi, fushat e rrezikut sipas planit janë: Prokurimi publik nuk është planifikuar sipas nevojave të zhvillimit, Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet departamenteve përkatëse, Përgatitja joefikase e ofertave të tenderit, Protokoli i qartë mbi komunikimin me ofertuesin mungon, Mungesa e kontrollit të kualitetit mbi implementimin e kontratave.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022, zyra e prokurimit ka vazhduar me publikimin e kontratave në ueb-faqen e prokurimit publik si dhe në atë komunale. Andaj, mbi parimin e transparencës palëve u janë dhënë informacione të nevojshme lidhur me të gjitha veprimtaritë që i ka kjo zyre sipas përshkrimit që u definua më lartë.

Administrata Komunale

Në mënyrë që kompetencat ligjore të zbatohen me standardet më të larta administrative e profesionale, administrata e Komunës së Kaçanikut, konform

dispozitave të nenit 78, të Statutit të Komunës së Kaçanikut (teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008 të datës 25/09/2008), përbëhet nga këto drejtori:

- 1.1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- 1.2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- 1.3. Drejtoria e Arsimit;
- 1.4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
- 1.5. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- 1.6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
- 1.7. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
- 1.8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 1.9. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Kuvendi i Komunës në raste të nevojshme mund të themeloj edhe drejtori tjera për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të komunës pas propozimit të kryetarit, në pajtim me këtë rregullore dhe organogramin komunal.

Fushat e rrezikut të cilat mund të ndodhin në këtë segment janë: Rreziqet që lidhen me ofruesit e shërbimeve logjistike nuk është adresuar në mënyrë adekuate, Performanca e dobët e Qendrës për Shërbime të Qytetarëve, Menaxhimi i të dhënave është i dobët.

Me ndarjet e duhura të drejtorive dhe sektorëve në administratën komunale, është mundësuar që të krijohet një sistem efikas i menaxhimit të shpenzimeve, kontratave dhe performancë të lartë të Qendrës për Shërbime të Qytetarëve.

Konflikti i interesit

Konflikti i interesit është situata e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, ku zyrtari ka interes privat, direkt ose indirekt, që ndikon, mund të ndikojë ose duket sikur ndikon në realizimin e gabuar të funksionit publik, në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve apo detyrimeve të tjera zyrtare. Në mbështetje të këtij përkufizimi, synimet në bazë të planit të integritetit janë që zyrtarët të njoftohen me situatat kur mund të shfaqet konflikti i interesit. Mbi këtë parim, është hartuar vendimi për caktimin e personit përgjegjës për konfliktin e interesit në kuadër të komunës i cili për periudhën raportuese nuk ka sinjalizuar që të ketë ndonjë rast të konfliktit të interesit.

Mospërputhja e funksioneve

Mospërputhja e funksionit është gjendja e mospajtimit kur një profesionist që mban një zyre angazhohet në të tjera profesione apo aktivitete që synojnë të sigurojnë të

ardhura pa aprovimin paraprak të punëdhënësit, ose që nuk përfshin aktivitete pedagogjike, shkencore, hulumtuese, artistike, kulturore, sportive dhe aktivitete botuese ose aktivitete të tjera të parashikuara me një tjetër ligj.

Bazuar në këtë fushë të rrezikut, vlen të përmendim se në administratën komunale të gjithë zyrtarët publik, e bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe nuk ka mospërputhje të funksionit. Secili zyrtar publik, ushtron veprimtarinë sipas kushteve të akt-emërimit dhe përshkrimit zyrtar të detyrave të punës. Në disa raste, zyrtarët publik kryejnë edhe detyra tjera të cilat nuk kalojnë 10% të angazhimit të përgjithshëm të tij/saj. Çdo drejtori apo sektor, është i planifikuar në kuadër të organogramit dhe çdo nëpunës ka edhe zëvendësin e tij në rast të pushimit. Kjo bëhet me qëllim që qytetarët dhe zyrtarët publik mos të shkëputen në marrjen e shërbimeve të ndryshme dhe puna të zhvillohet në konsistencë.

Deklarimi i pasurive

Mospërputhja e deklarimit të pasurisë së kërkuar është gjendja kur një profesionisti që mban një zyre i kërkohet me ligj të raportojë dhe të komunikojnë pasuritë e tij/saj subjekteve përkatëse pas marrjes apo ndërprerjes për të mbajtur një post publik.

Nga të dhënat zyrtare që posedojmë, kjo çështje rregullohet nëpërmjet Agjencionit Kundër Korrupsionit. Rrjedhimisht, të gjithë zyrtarët që mbajnë post publik dhe kanë për obligim deklarimin e pasurisë, e bëjnë këtë në mënyrë të rregullt dhe nuk është paraqitur asnjë problem përgjatë periudhës raportuese. Gjithashtu edhe për deklarim të pasurisë është caktuar personi përgjegjës.

Kabineti i Kryetarit

Te fusha e rrezikut që ndërlidhet me Kabinetin e Kryetarit, rreziku potencial është definuar në këtë formë: Funkcioni i kabinetit nuk është resursuar në mënyrë adekuate me stafin e duhur profesional kompetent, Zinxhiri komandues nuk respektohet në tërësi, Mekanizmi i ankesave nuk ekziston etj.

Kryetari i Komunës është përkujdesur që pjesë e kabinetit të tij të jenë persona adekuat, profesional dhe të pranueshëm për masën. Në këtë kontekst, është krijuar ambient i favorshëm i punës ku gjithsecilit iu ndahen përgjegjësitë dhe se të gjithë janë të gatshëm t'i ndihmojnë njeri-tjetrit në arritjen e objektivave të cilat i cakton pikërisht ai.

Bashkëpunimi i ndërsjellë i sektorëve dhe drejtorive ka dhënë rezultatet e veta. Është ngritur performanca e përgjithshme e komunës, janë dëgjuar kërkesat dhe ankesat e qytetareve, janë aplikuar masa të nevojshme në ngritjen e cilësisë së shërbimeve etj. Me fjalë tjera, kabineti i kryetarit është i obliguar që të funksionoj si trup unik, me qëllimin e vetëm që zhvillimi i politikave lokale të jetë në harmoni me kërkesat e qytetarëve dhe si të tilla t'i përgjigjen atyre në çdo kohë. Në anën tjetër, delegimi i kompetencave tek stafi mbështetës, në këtë rast te drejtorët e drejtorive komunale,

është mëse i nevojshëm sepse rritë performancën e drejtorive dhe njëkohësisht rritë efikasitetin në zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve

Te kjo fushë përkufizimi kryesor i rrezikut është se licencimi i shërbimeve publike dhe objekteve nuk është efikase dhe i mungon kontrolli me faktorët kryesor të rrezikut si: Menaxhimi/realizimi i projekteve kapitale është i paefektshëm, Organizimi aktual i transportit publik të udhëtarëve nuk është plotësisht efikas, Fondi i pamjaftueshëm emergjent në rast të situatave emergjente, Menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në menaxhimin e mbeturinave, Mungesa e kapaciteteve të stafit në dhënien e shërbimeve publike dhe procedurat administrative.

Mbi këtë bazë, vlen të theksohet se organi përgjegjës për shërbimet publike është Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike dhe sipas raportit për vitin 2022, kjo drejtori i ka arritur objektivat e saj me theks të veçantë në realizimin e projekteve kapitale, transportit publik, menaxhimit të mbeturinave, situatave emergjente etj., duke krijuar stabilitet të plotë në funksion të shërbimeve publike të duhura për qytetarët.

Inspektimi

Me zyrën e inspektoratit udhëheqë kryeinspektori. Pjesë e kësaj zyre janë inspektorët komunal të përcaktuar me akt-emërime. Zyra e Inspektoratit do të jetë përgjegjëse për performancën e detyrave si në vijim: Mbikëqyrjen dhe aplikimin e ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut, sanitarisë, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban-komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj; Implemetimin e praktikave të inspektionit të tregut duke përfshirë shitjen e ilegale të të mirave materiale, afatin e përdorimit të artikujve, ushtrimin e biznesit në pajtueshmëri me orarin e punës; Të sigurojë mbrojtjen efektive të konsumatorit, fillimisht përmes inspektimit të artikujve ushqimor, mishit, shpezëve dhe prodhimeve të qumështit; Të sigurojë standarde të larta në lëmin e mbrojtjes së ambientit, kushteve sanitare dhe higjienës publike ku përfshihen: inspektimi i cilësisë së ujit dhe metodat e hedhjes së mbeturinave; Mbikëqyrë implementimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK), planeve zhvillimore urbane (PZHU), planeve rregulluese urbane (PRRU), kushtet e lokacionit dhe të ndërtimit, përkatësisht të rikonstruimit të objekteve industriale, të objekteve për prodhim dhe qarkullim dhe të mallrave, të ndërtesave banesore dhe ndërtesave tjera, të varrezave, objekteve për furnizim me ujë, objekteve të komunikacionit; Të zbatojë inspektimin në lëmin e ndërtimit dhe rindërtimit, për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e ndërtimit dhe planifikimit me theks të posaçëm në ndërtimin ilegal; Të sigurojë inspektimin në lëmin e shërbimeve komunale, me theks të veçantë në transportin publik, duke inspektuar shërbimet e autobusëve, lejet e taksive dhe objektet transportuese publike; Ekzekuton vendimet, përcjell, evidenton dhe ndërmerr masa ligjore ndaj subjekteve-operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj zyre; Përgatitë aksione konkrete për eliminimin e të metave që paraqiten në raste konkrete në bashkëveprim me organet

tjera kompetente si dhe bashkëvepron me subjektet shtetërore si policia, gjykata, prokuroria etj.;

Në faktorët e rrezikut të cilat determinojnë inspektimin si çështje ku duhet patjetër të fokusohet në plan të integritetit janë pikërisht çështjet që ndërlidhen me punët dhe detyrat e zyrës të inspektoratit. Fushat e rrezikut janë: Resursimi joadekuat i funksionit të inspektimit, Nuk kryhet asnjë inspektim i rregullt, Organizimi i sistemit të inspektimit nuk është efikas dhe i ndjeshëm ndaj shkeljeve të integritetit, Ekziston mungesa e implementimit të planeve të inspektimit.

Me krijimin e zyrës të inspektoratit në kuadër të zyrës të kryetarit, është shndërruar inspektimi në element thelbësor për eliminimin e faktorëve të cilët dëmtojnë integritetin e institucionit në pjesën kur bëhet fjalë për inspekte. Prandaj, sipas raportit të kësaj zyre për periudhën raportuese, vërehet se ky segment është bazë e mjaftueshme të cilat mbrojnë dhe promovojnë integritetin.

Urbanizmi dhe Planifikimi

Urbanizmi dhe Planifikimi janë detyra të cilat për nga përgjegjësia i takojnë Drejtorisë të Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kjo drejtori, ndër tjerash, është përgjegjëse për performancën e detyrave si në vijim:

Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjellë dhe studion zhvillimin hapësinor të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore); Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera; Në procesin e hartimit të planeve hapësinore, bashkëpunon dhe sinkronizohet me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe komunës; Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës; Harton programe-detyra projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar; Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës; Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivo-teknike për ndërtimin e objekteve lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike; Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës etj.

Në këtë fushë, sipas planit komunal për integritet, rrezik potencial është identifikuar mungesa e kontrollit ku përveç kësaj, u identifikuan edhe këta faktorë: Plani i zhvillimit nuk është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Hapësinor, Mungesa e ndërgjegjësimit dhe transparencës në çështjet e zhvillimit urban, Kanalet e dobët për marrjen e reagimeve nga aktorët e jashtëm etj.

Në periudhën raportuese, fusha e Urbanizmit dhe Planifikimit ishte në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale, dokumente të cilat i paraprijnë krijimit të infrastrukturës moderne për zhvillimin e Komunës së Kaçanikut.

PËRMBLEDHJE

Planin Komunal për Integritet 2022-2026, është dokument nga i cili përcaktohet forma dhe mënyra e ngritjes dhe ruajtjes të integritetit institucional. Përveç fushave specifike të rrezikut që u përmendën më lartë, të cilat janë raportuar për shkak të rëndësisë tepër të madhe që kanë, janë edhe shume segmente tjera të cilat kanë rëndësi jetike për funksionimin mirëfilltë të Komunës së Kaçanikut.

Kontrolli, disiplina, shpërndarja e përgjegjësi, parimi i subsidiaritetit, llogaridhënia etj, janë detyrat e përditshme që për synim kanë implementimin e reformave graduale në administratën publike me synim kryesor të përafrimit me vendet e Bashkimit Evropian.


Angazhimi i Komunës të Kaçanikut ishte dhe do të vazhdojë të jetë në shërbim të qytetarëve, me theks të veçantë në ngritjen e vazhdueshme të integritetit institucional.

Si përfundim, Komuna e Kaçanikut vazhdimisht është e angazhuar në hartimin e akteve komunale të cilat kanë për qëllim të forcimit të mekanizmave kontrollues gjithherë në funksion të ngritjes dhe promovimit të integritetit. Andaj, marrë parasysh sfidat që e përcjellin shoqërinë tonë, ekspozimin ndaj dukurive negative të cilat janë prezentë në çdo sferë, komuna do të vazhdojë që të përkrah në mënyrë të pandërprerë këtë aspekt.




Drejtoresha e Administratës së
Përgjithshme

Znj. Dardana Dauti



I	Data 20.11.23	Vendi	KAGANI
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02	30223	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Oeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL 270/23 Datë: 13.11.2023
1.Zyrtari konfirmues	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për
vlerësimin ligjor	Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të
2.Zyrtari hartues	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit
vlerësimin ligjor	Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.06-350/01-27224/23 për caktimin e lokacionit në varrezat e fshatit Doganaj dhe Saponicë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut

I nderuar kryetar llazi,
I nderuar kryesues Murseli,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 08.11.2023, ka pranuar nga MAPL Vendimin 01 Nr.06-350/01-27224/23 për caktimin e lokacionit në varrezat e fshatit Doganaj dhe Saponicë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 31.10.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Kaçanikut:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimit 01 Nr.06-350/01-27224/23 për caktimin e lokacionit në varrezat e fshatit Doganaj dhe Saponicë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 31.10.2023.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimi 01 Nr.06-350/01-27224/23 për caktimin e lokacionit në varrezat e fshatit Doganaj dhe Saponicë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, konstatoi se:

- Baza ligjore nuk është referuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor;
- Të shikohet lokacioni i planifikuar sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi;
- Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj;
- Nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor pjesën tekstuale dhe pjesën grafike në fuqi sipas Ligji Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor;

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 06-350/01- 27224/23
Kaçanik, 31.10.2023

Në mbështetje të nenit 12.2 (d), 14.1 lidhur me nenin 17 (c) dhe (p) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6. 2 (h) dhe (p) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit 01Nr. 06-350/01-27224/23 prej datës 17.10.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 tetor 2023, mori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT E
FSHATIT DOGANAJ DHE SOPONICË

1. Me këtë vendim, caktohet lokacioni me destinim për Varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë, në numër të parcelës P-70917026-00143-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 01.49.95 ha, Zona Kadastrale Doganaj, e evidentuar në pronësi Komuna e Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e planit, Certifikata e pronës cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës; Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb faqen e Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë (përmes saj njoftohen organet tjera relevante);
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli